



Partia Demokratike



Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr. 11, Tiranë.

Nr. 79 Prot

Tiranë më, 05.03.2023

Lënda: Kërkesë për rregjistrimin në KQZ të **PARTISË DEMOKRATIKE**, si subjekt zgjedhor
Drejtuar: **KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

TIRANË

Mbështetur në Ligjin Nr. 10019 datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 64, **PARTIA DEMOKRATIKE** i kërkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve rregjistrimin e saj si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme vendore të datës 14.05.2023.

Në përputhje me nenin e sipërpërmendur të Kodit Zgjedhor, së bashku me kërkesën tonë për rregjistrim po ju paraqesim:

1. Dokumentacionin provues mbi legjitimitetin e organeve drejtuese të Partisë Demokratike të Shqipërisë të kërkuar nga neni 64, pika 2 e Kodit Zgjedhor.
2. Kryetari i **PARTISË DEMOKRATIKE**, **Z. Sali BERISHA** është personi i vetëm që mund të paraqesë për regjistrim, në emër të Partisë Demokratike, kandidaturat për kryetarë të bashkive dhe listat e këshilltarëve për çdo zonë zgjedhore.
3. Sikurse provohet edhe nga dokumentacioni ligjor shoqërues:
 - a. **Emri zyrtar** i Partisë është: **PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË**.
 - b. **Shkronjat** nistore janë **PD/PDSH**.
 - c. **Vula** e Partisë është ajo e stampuar më poshtë.
 - d. **Adresa:** Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr.11, Tiranë.
4. **Financier** i **PARTISË DEMOKRATIKE** është z. **Arben Ibroja**.
Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr.11, Tiranë.
5. Personat përgjegjës për komunikimin e **PARTISË DEMOKRATIKE** me KQZ janë z.**Ledio Nuraj** dhe z. **Franci Nuri**.
Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr.11, Tiranë.

KRYETARI



Model KQZ-04-02

REPUBLICA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

DEKLARATA E ANGAZHIMIT SOLEMN E KRYETARIT TË PARTISË POLITIKE

Zgjedhje për Organet e Qeverisjes Vendore	Data e zgjedhjeve	14/05/2023	
I) TË DHËNAT E KRYETARIT	PARTIA DEMOKRATIKE	PD/PDSH	BLV. ZHAN D'ARK NR.11
	Partia (emri zyrtar i partisë)	(shkronjat nistore)	(Adresa e partisë)
	Kryetari i partisë z/znj	SALI BERISHA	
	(emër, atësi, mbiemër i kryetarit të partisë)		

DEKLAROJ NË CILËSINË E KRYETARIT TË PARTISË:

Angazhimin solemn të Partisë tonë se, pjesëtarët e strukturave drejtuese dhe administrative, të anëtarësisë, kandidatëve për deputetë/ drejtues/ anëtarë të organeve të qeverisjes vendore, deputetë/ drejtues/ anëtarë të organeve të qeverisjes vendore dhe gjithë strukturave të tjera të angazhuara nga subjekti në këto zgjedhje, funksionarë/ ish funksionarë publik do të refuzojnë të marrin pjesë në praktikën e blerjes së votës, marrjes së financimeve apo përfitimeve të kundërligjshme, veçanërisht nga ato që vijnë nga aktivitete kriminale.

Angazhohemi të zbatojmë rregulla për të gjithë anëtarësinë, administratën dhe ndjekësit tanë që: Të mos premtojnë/ ofrojnë/ japin para, mallra, shërbime dhe/ose nxisin premtime për punësim apo trajtime të tjera të veçanta votuesve dhe/ose të tjerëve, duke përfshirë familjet e votuesve apo komuniteteve të ndryshme apo të veprojnë në mënyrë të tillë që synohet të ndikojë, ose arsyeshëm pritet të ndikojë në mënyrën se si votuesit japin votën e tyre;

- Të zbatojmë parimet bazë të trashëgimisë zgjedhore europiane për votim universal, të barabartë, të lirë, të fshehtë, dhe të drejtpërdrejtë;
- Të respektojmë të drejtat dhe liritë politike të shtetasve, organizatave, partive politike, për të promovuar dhe debatuar çështje politike;
- Të mos përfshihemi në praktika kërcënuese ose pengimi për të ushtruar të drejtën e votës dhe shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve.
- Të bëjmë publike në kohë reale pranë KQZ-së dhe faqen zyrtare të subjektit tonë politik çfarëdojloj donacioni si dhe të refuzojmë dhurime në mjete monetare apo në natyrë që:

- Tejkalojnë limitin e përcaktuar për donacion;
- Janë kontribute në para apo në natyrë me prejardhje nga burime të ndaluara që përfshijnë edhe të ardhurat nga krimi, individë, kompani të huaja nga vende me origjinë të dyshimtë/të parajsave fiskale;
- Janë donacione të cilat nënkuptojnë apo perceptohen si favorizime për dhënie kontrata publike, emërimë në funksione publike apo përfitime të tjera që shkojnë në emër e për llogari të dhuruesit.

Kryetari i Partisë

Sali Berisha
(emër, atësi, mbiemër i kryetarit të partisë)

(nënshkrimi)

5/3/2023

(data dd/mm/vvvv)





Partia
Demokratike

Nr. 80 Prot.

Tiranë më 05.03.2023

Lënda: *Përcillet dokumentacion për regjistrim subjekti zgjedhor*

Z. ILIRJAN CELIBASHI
KOMISIONER SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë

I nderuar z. Komisioner,

Partia Demokratike e Shqipërisë është krijuar sipas Urdhërit Nr.12 datë 19.12.1990 të Ministrit të Drejtësisë dhe rezultoi e regjistruar në Regjistrin e Partive Politike.

Regjistrimet e akteve të fundit të këtij subjekti, në Regjistrin e Partive Politike, datojnë ato të pas Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të 29 Prillit 2018. Këto regjistrime përfshijnë pasqyrimin në regjistër të organeve drejtuese të PDSH si Këshilli Kombëtar, Kryetari i Partisë, Sekretari i Përgjithshëm dhe sekretariatet.

Gjithashtu të regjistrueshme, por ende të papasqyruara në Regjistrin e Partive Politike, janë vendimet e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë të datës 17 Korrik 2021, dhe organet drejtuese të dala nga ky Kuvend, me përjashtim të Kryetarit të Partisë, zgjedhja e të cilit aktualisht është e ankimuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. çështje 6288, datë 30.06.2021, aktualisht në process gjykimi.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 16.12.2021 është depozituar kërkesa e palës kërkuese "Partia Demokratike e Shqipërisë", përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit, në referim të Ligjit Nr.8580 datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar.

Objekt i kërkesës, ishte **depozitimi i ndryshimeve statutore, sipas vendimeve të marra nga Kuvendi i Partisë Demokratike i datës 11.12.2021**, Kuvend i cili ishte thirrur referuar parashkimeve statutore nga $\frac{1}{4}$ e anëtarëve/delegatëve të Kuvendit.

Me vendimin nr. 3 datë 25.03.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës së palës kërkuese, Partia Demokratike e Shqipërisë përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit:

- Depozitimin e vendimeve të Kuvendit të PDSH duke regjistruar ndryshimet përkatëse në rregjistrin e partive politike:

- *Vendimin Nr.1 datë 11.12.2021, me anekset bashkëlidhur Statutin e Partisë Demokratike, të Kuvendit Kombëtar të Partisë;*
- *Vendimin Nr.2 datë 11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike;*
- *Vendimin Nr.3 datë 11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike;*
- *Vendimin Nr.4 datë 11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike;*
- *Vendimin Nr.5 datë 11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike;*
- *Vendimin Nr.6 datë 11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike;*
- *Vendimin Nr.7 datë 11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike.*

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim deputeti Enkelejd Alibeaj pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, cila me vendimin nr. 44, datë 03.03.2023, vendosi:

1) *Mospranimin e ankimit të ankuesit Partia Demokratike të Shqipërisë përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, të ushtruar ndaj vendimit nr. 508 rregj. them., datë vendimi 22.04.2022 me objekt "Disponim ankimi" të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si vendim ndaj të cilit nuk lejohet ankim.*

2) *Prishjen e vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dergimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate me tjetër trup gjykues.*

3) *Kundër këtij vendimi lejohet rekurs i veçantë në Gjykatën e Lartë brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit të arsyetuar.*

Në funksion të regjistrimit si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme vendore të datës 14.05.2023 për kryetarë të bashkive, Partia Demokratike ka detyrimin politik dhe ligjor të paraqesë kërkesën përkatëse për regjistrim si subjekt zgjedhor pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas parashikimeve të nenit 64 të Kodit Zgjedhor, por në raport me kornizën ligjore ekzistuese konstaton se gjendja aktuale e organeve të saj më të larta drejtuese, krijuar me vullnet të lirë nga anëtarësia e saj sipas disponimeve të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar, nuk rezulton të jetë e pasqyruar në regjistrin e Partive Politike dhe si e tillë t'i vihej në dispozicion KQZ në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga neni 64 i Kodit Zgjedhor.

Përsa më sipër, duke konsideruar se:

- **Kuvendi i Partisë Demokratike të Shqipërisë i datës 11.12.2021, si dhe Statuti i PDSH dhe organet e partisë që burojnë prej tij janë aktet e fundit ligjore në fuqi, të regjistrueshme në Regjistrin e Partive Politike, sipas dispozitave të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar.**

- **Vendimi nr.3 datë 25.03.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka certifikuar Kuvendin Kombëtar të Partisë Demokratike të datës 11.12.2021, është ende në fuqi i pashfuqizuar.**
- **Vendimi nr.44, datë 03.03.2023 i Gjykatës së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm është një vendim jo përfundimtar dhe jo i formës së prerë në kuptim të parashikimeve të nenit 451, shkronja “ç”, i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, i cili do të rekursohet nga ana jonë sapo të na komunikohet vendimi i arsyetuar nga Gjykata e Apelit.**
- **Rekordet e organeve drejtuese të Partisë Demokratike të Shqipërisë që figurojnë të pasqyruara në Regjistrin e Partive Politike janë të vjetra dhe nuk pasqyrojnë korrektësisht organet drejtuese të saj, veçanërisht përsa i përket ish-kryetarit të partisë z. Lulzim Basha i cili, përveçse është shkarkuar nga kjo detyrë në Kuvendin Kombëtar të datës 11.12.2021 ka dhënë edhe dorëheqjen me një akt publik në datën 21.03.2022.**
- **Kërkesa për regjistrim e subjektit zgjedhor në zgjedhje, sipas nenit 64 të Kodit Zgjedhor dhe akte të tjera që lidhen me të, janë akte ekskluzive të cilat i takojnë Kryetarit të Partisë dhe nuk mund të delegohen te asnjë tjetër.**
- Mospasqyrimi i akteve të sipërcituara, në regjistrin e Partive Politike mund të rrezikojë proceduralisht, për herë të parë që nga viti 1990 regjistrimin e partisë më të madhe të opozitës në procesin zgjedhor,

Nisur nga sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj, regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme vendore të datës 14.05.2023, në përputhje me parashikimet e nenit 64 e vijues të Kodit Zgjedhor dhe sipas jurisprudencës së krijuar nga vetë KQZ me vendimin e saj nr. 230 dt.27.04.2019, sipas dokumentacionit që do të gjeni bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar paraprakisht,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

FLAMUR NOKA





REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

Nr. 1346/222 Akti
Dt. 15.12.2021 Regj

Nr. 3 Vendimi
Dt. 25.03.2022 Vendimi

VENDIM

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:
AGRON ZHUKRI – GJYQTAR

asistuar nga sekretare gjyqesore **Ornela Marashi**, sot më datë 25.03.2022 mori në shqyrtim ne seance gjyqesore publike, çështjen civile me Nr. 1346/222 Regj. Themeltar që i përket:

KËRKUES:

Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit të P.D.SH, me adresë Bulevardi “Zhan d'Ark”, Nr. 11, Tiranë, përfaqësuar me autorizim me nr. 01 prot date 13.12.2021 nga Ivi Kaso.

OBJEKT:

Depozitim ndryshimesh statutore dhe vendimarrje të Kuvendit Kombëtar.

BAZË LIGJORE:

Neni 9 e vijues të ligjit nr. 8580 datë 17.02.2000 (i ndryshuar).

Gjykata pasi shqyrtoi në tërësi, aktet shkresore bashkangjitur kërkesës me objekt: Depozitim ndryshimesh statutore dhe vendimarrje të Kuvendit Kombëtar.

VEREN

Pala kërkuese “Partia Demokratike e Shqipërisë” i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesën objekt shqyrtimi, e cila është regjistruar në datën 16/12/2021 dhe në vijim nënshtruar procedurave të shortit elektronik dhe kalimit të dosjes te Gjyqtari i çështjes.

Pas njohjes paraprake me materialet e kërkesës, gjyqtari i çështjes i ka drejtuar Kryetarit në detyrë të Gjykatës një kërkesë për heqje dorë nga gjykimi i çështjes, e cila nuk është pranuar duke u urdhëruar vazhdimi i gjykimit nga i njëjti gjyqtar.

Në funksion të vazhdimit të shqyrtimit të kërkesës, Gjykata kërkoi tërheqjen e praktikës së dosjes së regjistrimit fillestar të Partisë Demokratike, dosje e regjistruar me Urdhrin Nr.12,

datë 19.12.1990 të Ministrisë së Drejtësisë pranë Zyrës së OJF-së. Me shkresën datë 28.12.2021 është kthyer përgjigje se dosja e regjistrimit të Partisë Demokratike të Shqipërisë është tërhequr më datë 20.12.2021 nga Gjyqtare Blerina Muça.

Po në datën 28.12.2021 Gjykata është njoftuar për depozitimin e Kërkesës nr.168/2 Prot., datë 24.12.2021 të Partisë Demokratike të Shqipërisë protokolluar me Nr.9497 Prot., dt.28.12.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt përjashtimin e gjyqtarit të çështjes nga shqyrtimi i kërkesës.

Në përputhje me paragrafin e fundit të nenit 75 të K.Pr.Civile, Gjykata ka qene ne pritje te përfundimit te shqyrtimit të kërkesës për përjashtim përpara kryerjes së veprimeve procedurale apo vendimarrjeve eventuale. Në datën 04.02.2022 me Vendimin nr. 191 Akti, dt. 04.02.2021 i Gjykata e Tiranës (Gjyqtar Arben Kostandini) ka vendosur “Mospranimin e kërkesës”.

Për efekt të vazhdimit të veprimeve në lidhje me kërkesën, Gjykata ka verifikuar në sistemin elektronik të Gjykatës së Tiranës ecurinë e shqyrtimit të kërkesës të PDSH nga Gjyqtare Blerina Muça e cila kishte caktuar datën 15.02.2022 për zhvillimin e seancës gjyqësore për marrjen në shqyrtim të kërkesës, seancë e cila u shty për në datën 18.03.2022.

Pas shtyrjes së sipërcituar, në zbatim të dispozitave të neneve 13 dhe 14 të Ligjit nr.8580 dt.17.02.2000 “Për Partitë Politike” të ndryshuar, me qëllim respektimin e afatit 30 ditor për shqyrtimin e kërkesës, Gjykata vendosi ne dhome keshillimi kryesisht pezullimin e gjykimit të çështjes deri në përfundimin e çështjes nga Gjyqtare Blerina Muça dhe tërheqjes së dosjes së regjistrimit fillestar të Partisë Demokratike.

Në datën 23.03.2022 pala kërkuese depozitoi kërkesën me nr. 2192 Prot., dt. 23.03.2022 me anë të së cilës, në bazë të nenit 298/paragrafi i dytë të K.Pr.Civile, i kërkonte Gjykatës vazhdimin e gjykimit si rrjedhojë e përfundimit të gjykimit dhe shpalljes së vendimit nga Gjyqtare Blerina Muça në datën 18.03.2022.

Në këto kushte Gjykata pas verifikimit të pretendimit të kërkuarit në sistemin elektronik të Gjykatës, vendosi të revokojë vendimin e pezullimit dhe të caktojë seancën gjyqësore brenda një afati sa më të shkurtër me qëllim zbatimin (për sa ishte e mundur) të neneve 13 dhe 14 të Ligjit nr.8580 dt.17.02.2000 “Për Partitë Politike” të ndryshuar

Në lidhje me legjitimitimin e kërkuarit :

Gjykata vëren se kërkesa është paraqitur nga Komisioni i Rithemelimit i Partisë Demokratike, (nëpërmjet përfaqësuesit të saj të autorizuar) organ i cili cilësohet si organi i përkohshëm drejtues i Partisë Demokratike të Shqipërisë, zgjedhur dhe miratuar nga vendimarrjet e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë të datës 11.12.2021.

Gjykata sqaron se verifikimi i legjitimitit të palëve, në përputhje me nenin 176 të K.Pr.Civile është detyrim thelbësor i procesit civil dhe në përmbushje të këtij detyrimi Gjykata pasi kreu verifikimin e aspektit formal të akteve të përfaqësimit duke i gjetur ato të rregullta dhe në përputhje me ligjin procedural.

Për sa i përket të drejtës aktive të Komisionit të Rithemelimit për t'iu drejtuar gjykatës si organi drejtues dhe përfaqësues i PDSH, Gjykata thekson se në përputhje me dispozitat e ligjit "Për Partitë Politike", neni 9, 10 e vijues, si dhe bazuar në praktikën gjyqësore të regjistrimeve të ndryshimeve në partitë politike, Gjykata nuk ka rol aktiv në emërimin/ndryshimet apo shkarkimet e organeve drejtuese apo të zgjedhurve në partitë politike, por ushtron vetëm kontrollin formal të ligjshmërisë së ndryshimeve statutore dhe verifikimin e respektimit të kërkesave të ligjit apo të statutit në proceset vendimarrëse të cilat pasqyrohen në regjistrin e partive politike.

Thënë ndryshe, nuk është vendimi gjyqësor që u jep të drejtën organeve të partisë apo të emëruarve në postet partiake për të ushtruar funksionet e tyre, por gjykata kontrollon dhe certifikon a posteriori, të drejtën e tyre për të ushtruar kompetencat organike dhe statutore që nga momenti i konstituimit.

Sa më sipër përbën një fakt gjerësisht të njohur, të mbështetur në praktikat ndër vite të partive politike (duke përfshirë edhe palën kërkuese), në dispozitat statutore të cilat hyjnë në fuqi menjëherë me miratimet e tyre në forumet vendimarrëse të partisë si edhe mbi të gjitha në vetë disponimet e nenit 9 të Ligjit nr.8580 dt.17.02.2000 "Për Partitë Politike" të ndryshuar i cili shprehet se:

"Partia politike njihet si person juridik që nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë. Deri në datën e regjistrimit, themeluesit e partisë mund të kryejnë veprime që janë të nevojshme për organizimin e saj, siç janë, sidomos, thirrja e zhvillimi i mbledhjes së themeluesve dhe zgjedhja e organeve drejtuese, por nuk mund të kryejnë veprimtari si parti politike".

Dispozita e sipërcituar e interpretuar për analogji edhe në rastet e regjistrimeve të mëvonshme (sipas nenit 14 të Ligjit nr.8580 dt.17.02.2000 "Për Partitë Politike" të ndryshuar) - sqaron qartazi që veprimtaria e brendshme organizative (zgjedhja e organeve drejtuese) e partive politike nuk kushtëzohet nga miratimi dhe regjistrimi gjyqësor, por ky i fundit nevojitet detyrimisht për certifikimin e ligjshmërisë në këto procese dhe legjitimimin ndaj të tretëve.

Bazuar në sa më sipër, në analizë të rastit objekt shqyrtimi, Komisioni i Rithemelimit legjitimohet në aspektin paraprak formal të paraqitjes së kërkesës dhe vënies në lëvizje të gjykatës si organ i zgjedhur dhe i emëruar nga Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike të Shqipërisë, por legjitimimi substancial bëhet nga verifikimi material nga ana e gjykatës i ligjshmërisë dhe i respektimit të normave statutore në thirrjen, mbledhjen dhe vendimarrjen e Kuvendit Kombëtar të PDSH të datës 11.12.2021.

Në lidhje me themelin e kërkesës:

Për të vlerësuar nëse duhen regjistruar aktet e paraqitura për shqyrtim dhe regjistrim, në regjistrin e partive politike, gjykata çmon se fillimisht duhet të gjykojë mbi kompetencën e organit që ka nxjerrë aktet objekt shqyrtimi, si dhe mbi ligjshmërinë e mbledhjes së organit në të cilin janë miratuar aktet përkatëse.

a) Si thirret Kuvendi Kombëtar dhe dispozitat e zbatuara

Statuti i miratuar në mbledhjen e 17 Korrikut 2021 përcakton në nenin 43, pika 2, se si rregull, mbledhja e Kuvendit Kombëtar mbledhet çdo katër vjet.

Neni 43 i statutit të 17 Korrikut 2021 përcakton se Kuvendi Kombëtar është organi më i lartë vendimmarrës i PDSH. Pika 1 e nenit 43 përcakton se antarësia e Kuvendit Kombëtar (delegatët) formohet *ex officio*, nga funksionarë të niveleve të ndryshme të PD, që bashkë me mandatin e funksionit të zgjedhur apo emëruar, zotërojnë edhe mandatin e delegatit. Në momentin kur një funksionar i PD, sipas statutit të 17 Korrikut 2021, zgjidhet apo emërohet në funksionin përkatës, marrin automatikisht edhe mandatin e delegatit në Kuvendin Kombëtar. Ky mandat zgjat katër vjet, deri në mbarimin e mandatit të Kuvendit (organit) të radhës. Pra, antarësia e Kuvendit Kombëtar në detyrë deri në zgjedhjen dhe konstituimin e Kuvendit të ardhshëm, mbetet e pandryshuar, me përjashtim të delegatëve individualë të cilëve u përfundon parakohe mandati i funksionit për shkak të të cilit zotërojnë mandatin e delegatit të Kuvendit Kombëtar.

Statuti i 17 Korrikut 2021 përmban rregulla standarte për thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar. Zhvillimi i mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, si çdo organ kolegjal, kalon nëpër disa hapa:

1. Thirrja e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar;
2. Verifikimi i thirrjes së mbledhjes;
3. Verifikimi i kuorumit për vlefshmërinë e mbledhjes;
4. Çelja e punimeve të kuvendit.

Nga analiza e dispozitave të statutit të 17 Korrikut 2021 ku bazohet thirrja e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar të 11 Dhjetorit 2021, vërehet se statuti përcakton dy lloj mbledhjesh të Kuvendit Kombëtar: i) mbledhje e zakonshme; ii) mbledhje e jashtëzakonshme. Lloji i mbledhjes përcaktohet nga mënyra e thirrjes së saj.

Mbledhja e Kuvendit Kombëtar, në përputhje me statutin e 17 Korrikut 2021, ka dy forma për tu thirrur dhe secila mënyrë ka dy mënyra. Forma përcaktohet nga kush ka të drejtë të thërrasë mbledhjen:

1. **Thirrja nga organet drejtuese (forma e zakonshme):**
 - a. Me vendim të Këshillit Kombëtar, bazuar në propozimin e kryetarit të partisë;

- b. Me vendim të Kryesisë, bazuar në propozimin e kryetarit të partisë:
2. **Thirrja nga pakica** (forma e jashtëzakonshme):

- a. Me kërkesë të 1/4 së antarëve të partisë;
b. Me kërkesën e 1/4 së delegatëve të Kuvendit Kombëtar.

Forma e zakonshme e thirrjes - Kuvendi Kombëtar është organ kolegjal, përfaqësues i antarëve. Roli i kryetarit të partisë është i kufizuar vetëm në propozimin për thirrje të Kuvendit. Vetëm propozimi nuk mjafton për ta thirrur atë. Statuti i'a ka besuar thirrjen e zakonshme organeve drejtuese që dalin prej Kuvendit (Këshilli Kombëtar zgjidhet drejtpërdrejt nga Kuvendi, ndërsa Kryesia zgjidhet nga Këshilli Kombëtar, pra derivon nga vullneti i Kuvendit Kombëtar).

Organet thirrëse e thërrasin Kuvendin për çështje që nuk janë kompetencë e tyre e që statuti ia jep vetëm Kuvendit Kombëtar, ose u nevojitet legjitimitet i plotë në vendimmarrje. Miratimi/ndryshimi i statutit dhe shkarkimi i kryetarit të partisë janë kompetencë e Kuvendit Kombëtar sipas nenit 43 të statutit të 17 Korrikut 2021.

Statuti, nëpërmjet mekanizmit të dyfishtë të thirrjes (propozimi – vendim), jo vetëm respekton hierarkine statutore të organeve ku Kryetari është organ i varur nga organi përfaqësues, por siguron edhe ndarjen e pushtetit përfaqësues nga ai ekzekutiv që përfaqësohet nga kryetari.

Forma e jashtëzakonshme e thirrjes – Pushteti epror vendimmarrës, sipas statutit të 17 Korrikut 2021 ushtrohet nga antarët vetëm me delegim tek Kuvendi Kombëtar, duke qenë se nuk parashikohet asnjë instrument i ushtrimit të drejtpërdrejtë të vullnetit (referendum i antarësisë) për çështje që janë kompetencë e Kuvendit. Statuti njeht parimin demokratik ligjor të ngritjes dhe funksionimit nga poshtë – lart të partisë, për rrjedhojë u njeht antarëve të drejtën që të jenë pjesë aktive në vendimmarrjet e rëndësishme. Kjo u njeht antarëve nëpërmjet të drejtës për të thirrur Kuvendin Kombëtar dhe vendosur në mënyrë autonome rendin e ditës së tij, jashtë vullnetit të organeve të tjera të partisë.

Si për çdo organ kolegjal shtetëror, publik apo jopublik edhe statuti i 17 Korrikut 2021 parashikon vetëthirrjen e tij apo thirrjen nga pakica, jashtë vullnetit të organeve drejtuese.

Në të gjitha këto raste, thirrja e organit kolegjal është e detyrueshme kur një *kuorum* i përcaktuar me aktin përkatës (kushtetutë, ligj, rregullore apo statut), kërkon thirrjen e organit. Thirrja nga ana tjetër është e ndarë nga formimi i *kuorumit* të mbledhjes dhe zhvillimi i saj.

Në kushte ekstreme, organet drejtuese të partisë, mund të mos vlerësojnë si të nevojshme mbledhjen e Kuvendit dhe vendimmarrjen për çështje të caktuara, në kundërshtim me vullnetin e antarësisë. Organet vendimmarrëse mund të jenë në konflikt interesi në raport me ushtrimin e një kompetence të Kuvendit. Të tilla do të ishin ndryshimet statutore që do të zvogëlonin apo ndryshonin kompetencat e organeve që kanë të drejtën e thirrjes së zakonshme apo shkarkimi i

tyre (psh. kryetarit) nga Kuvendi. Në këto kushte, këto organe do të refuzonin mbledhjen e Kuvendit.

Me qëllim shpangjen e bllokimit të vullnetit të anëtarësisë, por nga ana tjetër ruajtjen e një balance, statuti ka vendosur një *kuorum* minimal për thirrjen nga pakica prej 1/4 të delegatëve përfaqësues, delegatëve të kuvendit ose 1/4 të anëtarëve me të drejtë vote të partisë. Ky prag kaq i lartë është vënë pikërisht prej faktit se thirrje të tilla duhet të jenë të jashtëzakonshme, dhe çështjet për shqyrtim të një rëndësie aq të madhe sa të motivojë një numër të lartë anëtarësh.

Vlen të theksohet fakti se; Statuti në nenin 43 nuk e ka përfshirë të drejtën e pakicës për të thirrur kuvendin në të njëjtën fjali ku rregullohet thirrja e zakonshme. Pra statuti nuk barazon thirrjen nga 1/4 e delegatëve apo anëtarëve me propozimin për thirrje të kryetarit. Jo vetëm pakica thërret organin e vet, por statuti garanton të drejtën e pavarur të pakicës për të vënë në lëvizje organin suprem të partisë, pa paragjykuar vendimmarrjen e tij.

Nëse Kuvendi Kombëtar do të kishte barazuar thirrjen nga pakica me propozimin nga kryetari, duke ia nënshtuar vendimmarrjes së Këshillit Kombëtar ose Kryesisë, jo vetëm do të zhbëhej e drejta e pavarur e pakicës, por do t'i nënshtrohej vullnetit të një organi në konflikt eventual interesi që do ta bllokonte. Në këtë rast formulimi do të ishte në një fjali të vetme.

Vendosja në një fjali të pavarur, dhe lidhëza "edhe" bëjnë dallimin që thirrja e Kuvendit nga 1/4 e anëtarëve apo e delegatëve është thirrje nga pakica siç parashikon doktrina dhe praktika legjislative, është e pavarur nga vullneti i organeve të tjera, është mekanizëm vetëthirrjeje i Kuvendit dhe është formë alternative e thirrjes.

Në të dy format e thirrjes, statuti i 17 Korrikut 2021, ashtu si legjislacioni tjetër i përmendur më sipër, vendos tre elemente të detyrueshëm: caktimi dhe publikimi i :

i) datës për thirrjen e kuvendit;

ii) afati 30-ditor nga momenti i thirrjes deri në datën e caktuar;

iii) rendi i ditës i përcaktuar paraprakisht.

Këto elemente të formës kanë rëndësi jo vetëm për transparencën, por edhe për marrjen dijeni në kohë të mjaftueshme të çështjeve për diskutim nga korpusi vendimmarrës, delegatët që ftohen në mbledhje.

Thirrja e jashtëzakonshme e ndjekur për mbledhjen e Kuvendit të datës 11 Dhjetor 2021 ndoqi mënyrën e thirrjes nga 1/4 e delegatëve. Kjo lloj thirrje ka dy aspekte themelore:

1. **Aspekti cilësor** – të drejtën e thirrjes e kanë vetëm delegatët, pra ata anëtarë që kanë një funksion që sipas statutit i jep *ex officio* edhe mandatin e delegatit.
2. **Aspekti sasior** – duhet që thirrjen ta kërkojnë jo më pak se 1/4 e delegatëve,

Plotësimi i këtyre kushteve si dhe caktimi i datës në një afat jo më herët se 30 ditë nga momenti i thirrjes dhe caktimi i rendit të ditës, janë kushtet e mjaftueshme për të thirrur Kuvendin.

Gjykata e gjen me vend të theksojë se të njëjtat dispozita dhe mekanizma të përshkruara më sipër, për thirrjen e Kuvendit Kombëtar të PDSH gjenden të pasqyruara edhe në statutet e paraardhëse të PDSH, konkretisht atij të 29 Prillit 2018 ku të njëjtat parashikime të formuluar në mënyrë identike, gjendeshin në nenin 47 pika 4 dhe 6 të tij, çka vërteton një mekanizëm të konsoliduar në vite dhe të konfirmuar në tërësi pavarësisht ndryshimeve statutores të viteve të fundit.

b) Procedura e ndjekur për thirrjen e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë së datës 11/12/2021

Rezulton nga materialet e depozituara në dosje, se një grup deputetësh dhe politikanësh të tjerë të Partisë Demokratike, në datën 10 Nëntor 2021 kanë depozituar në zyrën e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të PD më shumë se 4200 formularë kërkesash të delegatëve të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike, për mbajtjen e Kuvendit Kombëtar të PDSH në datën 11.12.2021 në orën 11.00.

Kjo procedurë është zhvilluar në përputhje me pikën 2, të nenit 43 të Statutit të PDSH-së, në fuqi në momentin e thirrjes së Kuvendit Kombëtar, i cili parashikon qartësisht mbledhjen e organit më të lartë drejtues të Partisë Demokratike të Shqipërisë me kërkesë të një numri anëtarësh dhe delegatësh të Kuvendit Kombëtar më të madh se $\frac{1}{4}$ e gjithë përbërjes të tij. Në rastin konkret numri i formularëve të kërkesave të paraqitura (4200) e tejkalon ndjeshëm numrin e kërkesave të nevojshme për thirrjen e Kuvendit Kombëtar, i cili për shkak se përbëhet nga 7646 delegatë mund të thirret në mënyrë të ligjshme kur këtë e kërkojnë jo më pak se 1912 anëtarë të tij, (Gjykata për këtë qëllim administroi dhe vlerësoi provën nr.24 bashkangjitur kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022)

Në përputhje me të njëjtën dispozitë statutores, nenin 43 pika 2 të Statutit të PDSH, data, ora e zhvillimit të Kuvendit si dhe rendi i ditës, ishin pjesë e kërkesës së delegatëve nënshkrues dhe thirrës së Kuvendit.

Këto të dhëna, të cilat Statuti i PDSH, kërkon në mënyrë të detyrueshme që të komunikohen të paktën një muaj përpara ditës në të cilën thirret Kuvendi Kombëtar, u bënë të njohura për të gjithë publikun me mjetet e informimit publik, njoftime në televizione kombëtare, konferenca shtypi, portale e rrjete sociale menjëherë pas njoftimit drejtuar Kryetarit të Këshillit Kombëtar si më sipër, (Gjykata për këtë qëllim administroi dhe vlerësoi provat nr. 9, nr.10, nr.11 bashkangjitur kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022).

Rendi i Ditës i Kuvendit Kombëtar, në përputhje me kompetencat e tij, sipas nenit 43 të Statutit, ishte si më poshtë:

- Miratimi i ndryshimeve statutove sipas propozimeve konform nenit 43/4 dhe 60 të Statutit të PDSH për rivendosjen dhe garantimin e demokracisë në vendimarrjen në forumet e Partisë Demokratike.
- Analiza e qëndrimeve dhe akteve të Kryetarit Basha ndaj parimeve themelore e normave të statutit dhe ndaj forumeve të Partisë Demokratike
- Vendimarrje sipas ndryshimeve statutove të propozuara dhe thirrja e referendumit të antarëve të Partisë Demokratike për të miratuar vendimet e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike
- Përcaktimi i aksionit politik opozitar të Partisë Demokratike të Shqipërisë
- Të ndryshme

Nga sa më sipër rezulton që nga pikëpamja procedurale dhe e përputhshmërisë së procedurave të aplikuara nga kërkuesit në raport me parashikimet e nenit 43 të statutit të Partisë Demokratike, procedura e ndjekur është në përputhje të plotë me parashikimet urdhëruese statutove, përsa i përket :

- Numrit minimal të nevojshëm të antarëve të Kuvendit Kombëtar të cilët kërkojnë mbledhjen e Kuvendit Kombëtar ;
- Afatit kohor brenda të cilit duhet paraqitur kërkesa për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar ;
- Elementët minimalë të cilët duhet të përmbajë kërkesa për mbledhje të Kuvendit Kombëtar, si dita, ora, vendi, rendi i ditës...

Statuti i PDSH në asnjë dispozitë të tij, nuk parashikon organin të cilit kërkuesit e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, duhet t'i drejtojnë kërkesën për mbledhjen e tij, në rastet kur mbledhja e Kuvendit kërkohet nga anëtarësia.

Përsa më sipër, edhe në këtë aspekt, formalizimi i këtyre kërkesave dhe përcjellja e tyre pranë Kryetarit të Këshillit Kombëtar, organ ky i cili në bazë të nenit 44 të statutit përcaktohet si organi më i lartë i cili drejton veprimtarinë politike të partisë në periudhën midis dy Kuvendeve, është në vlerësim të gjykatës i ligjshëm dhe i pa kontestueshëm.

Pas verifikimit të aspekteve procedurale të mbledhjes së Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021, Gjykata ka hetuar cilësitë e kërkuesve të mbledhjes së tij. Paragrafi i parë i nenit 43 të statutit të PDSH përmban një listë shteruese funksionarësh të cilët përbëjnë Kuvendin Kombëtar të PDSH.

Për shkak se në secilin nga mbi 4200 formularët e kërkesave të depozituara për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar, nënshkruerit e identifikonin veten, përveçse me gjeneralitetet përkatës, edhe me funksionin të cilin mbanin në strukturat e Partisë Demokratike gjykata verifikoi në radhë të parë se secili nga funksionet e nënshkruerëve përfshihej në listën e funksioneve të cilat përbëjnë Kuvendin Kombëtar të PDSH sipas nenit 43 pika 1 të statutit të PDSH.

Gjithashtu gjykata verifikoi edhe nëse shtetasit nënshkruer të thirrjes së Kuvendit Kombëtar përfshiheshin në listën emërore të funksionarëve të PDSH të cilët, në momentin e

thirrjes së tij, përbënin listën e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar. Për këtë qëllim gjykata pasi administroi provat shkresore, konkretisht provën nr.3, nr. 4 dhe nr. 22 të bashkëngjitur kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022, vërejtë se listat bashkëngjitur këtyre dokumentave përbëjnë listë të plotë zyrtare dhe të detajuar të shtetasve të cilët përbënin Kuvendin Kombëtar të PDSH, në momentin e thirrjes së tij nga anëtarësia.

Konkretisht me shkresat e administruara si provat nr. 3 dhe nr.4 të përcjella me kërkesën e palës kërkuese, respektivisht, kryetarja e LDGSH zj. Albana Vokshi dhe Kryetari i FRPD z. Belind Këllici, i përcjellin Kryetarit të Këshillit Kombëtar të PDSH z. Edi Paloka listën zyrtare të delegatëve në Kuvendin Kombëtar të cilët përcaktohen nga organizatat e tyre, në përputhje me parashikimet e nenit 43, pika 1 gërma ë) e statutit të PDSH. Listat e bashkëngjitura përbëjnë dokument zyrtar të LDGSH dhe FRPD si organizata partnere të PD, sipas nenit 58 të statutit të PDSH, dhe si të tilla ato merren parasysh nga gjykata.

Gjithashtu gjykata administroi me cilësinë e provës nr. 22 bashkëngjitur kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022 edhe listën e plotë të delegatëve të Kuvendit Kombëtar, përcjellë zyrtarisht Kryetarit të Kuvendit Kombëtar z. Edi Paloka, në datë 11.11.2021 nga ana e Degës nr.3 të Partisë Demokratike Tiranë.

Shkresës zyrtare të kësaj Dege të PDSH i bashkëlidhet edhe lista e plotë emërore e delegatëve që përbëjnë Kuvendin Kombëtar të PDSH, e shkarkuar kjo e fundit nga aplikacioni Blu System, aplikacion zyrtar i PDSH. Lista bashkëlidhur është e përcjellë me shkresë zyrtare dhe e vulosur me vulën e degës 3 të PDSH Tiranë, dhe si e tillë i plotëson edhe elementët formalë për tu konsideruar një dokument zyrtar.

Nga verifikimi i kryer nëpërmjet krahasimit të emrave dhe funksioneve të nënshkruesve të thirrjes së Kuvendit Kombëtar me listat e sipërcituara rezulton se nënshkruesit e formularëve të kërkesave të thirrjes së Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021 janë anëtarë/delegatë të këtij organi, për shkak të funksionit që gjithsecili prej tyre mban.

Përsa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike është thirrur në mënyrë të ligjshme nga një numër anëtarësh/delegatësh më i madh se ¼ e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij.

Pas verifikimit të ligjshmërisë së thirrjes së Kuvendit Kombëtar, për të vlerësuar ligjshmërinë e mbajtjes së tij dhe të marrjes së vendimeve përkatëse, të cilat kërkohet të regjistrohen, Gjykata administroi provat nr. 18, nr. 19 dhe nr. 23 bashkëngjitur kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022 përkatësisht proces -verbalin e punimeve të Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021 të firmosur nga 5 anëtarët e Komisionit Drejtues të Punimeve të Kuvendit dhe 3 anëtarët e Sekretariatit Teknik, materialin e plotë filmik të punimeve të Kuvendit të përmbajtur në një USB, si dhe raportin e plotë teknik të kompanisë së specializuar të IT e cila ka menxhuar sistemin elektronik të identifikimit dhe mbikëqyrjes se aksesit të delegatëve në ambientet në të cilat janë zhvilluar punimet e Kuvendit.

Të tre këto dokumente, të cilat i janë paraqitur gjykatës në formën e kërkuar nga ligji, përbëjnë provë të plotë për të vërtetuar faktin dhe për t'i formuar Gjykatës bindjen se, Kuvendi Kombëtar i PDSH është mbledhur në mënyrë të ligjshme dhe në ambientet e stadiumit "Air Albania", ku janë zhvilluar punimet e tij, në pjesën e dedikuar të delegatëve të Kuvendit, kanë marrë pjesë 4935 delegatë, prezenca fizike e të cilëve ka bërë që Kuvendi të ketë *kuorumin* e nevojshëm që ky organ të konsiderohet i mbledhur dhe të mbajë punime e e të marrë vendime në mënyrë të ligjshme në përputhje me dispozitat statutoe.

Një vëmendje të veçantë gjykata i ka kushtuar edhe vlerësimit të formalizimit të organit i cili drejton punimet e Kuvendit Kombëtar, për shkak të parashikimit të veçantë të këtij momenti në statutin e PDSH.

Fjalia e fundit e paragrafit të dytë të nenit 43 të Statutit të PDSH, parashikon se "*Punimet e Kuvendit drejtohen nga një Komision i përbërë nga 5 anëtarë, i cili zgjidhet në fillim të punimeve të tij, me propozim të Kryetarit të Partisë*"

Gjykata e vlerëson këtë parashikim jo si një të drejtë por si një përgjegjësi e cila i ngarkohet Kryetarit të partisë, për të propozuar një Komision i cili pasi aprovohet nga Kuvendi drejton punimet e këtij të fundit. Mosushtrimi i kësaj përgjegjësie, në vlerësimin e gjykatës, nuk pengon organin më të lartë drejtues të PDSH, Kuvendin Kombëtar, në ushtrimin e sovranitetit të tij dhe në emërimin e një Komisioni me 5 anëtarë që drejtojnë punimet e Kuvendit.

Për këtë nevojitet që, sipas dispozitave statutoe, së paku Kryetarit të partisë t'i garantohet mundësia për të propozuar Komisionin drejtues të punimeve. Në vijim, ushtrimi ose mosushtrimi i kësaj përgjegjësie nga ana e Kryetarit të PDSH nuk çënon të drejtën e pakufizuar të Kuvendit Kombëtar për të përcaktuar me votë komisionin që drejton punimet e Kuvendit.

Në vijim të këtij arsyetimi, Gjykata ka administruar provën nr. 5 bashkangjitur kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022 "*Njoftim për ushtrimin e detyrimeve statutoe për mbarëvajtjen e Kuvendit Kombëtar*" drejtuar z. Lulzim Basha nga një grup deputetësh përfaqësues të anëtarëve të cilët thërrasin Kuvendin Kombëtar, si dhe mandatin postar bashkëlidhur.

Nga shyrtimi i këtij dokumenti shkresor, i paraqitur nga kërkuesi në formën e kërkuar nga ligji, rezulton së në datën 09.12.2021 një grup deputetësh përfaqësues të anëtarëve që kanë kërkuar mbledhje e Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021 kanë vënë në dijeni zyrtarisht Kryetarin e PDSH mbi përgjegjësinë e tij për të përcaktuar 5 anëtarë të Komisionit që drejton punimet e Kuvendit, dhe po në të njëjtën ditë, sipas mandatis postar, kjo shkresë është dorëzuar pranë punonjësit të protokollit të Partisë Demokratike të Shqipërisë. Pavarësisht kësaj, ashtu si rezulton edhe nga proces-verbali i mbledhjes së punimeve të Kuvendit të datës 11.12.2021 si dhe nga materiali filmik i administruar, deri në çeljen e punimeve të tij, Kuvendit Kombëtar nuk i është paraqitur asnjë propozim nga Kryetari i PDSH për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit drejtues të punimeve. Në kushtet e konstatimit të mosushtrimit të kësaj përgjegjësie statutoe

nëpërmjet mungesës së një përgjigje shkresore si dhe të mospjesëmarrjes së Kryetarit të PDSH në mbledhjen e Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021, Kuvendi Kombëtar me propozim të Kryetarit të Këshillit Kombëtar të PDSH z.Edi Paloka, i cili çeli edhe Kuvendin, miratoi me votim të hapur dhe me shumicë votash, në prani të më shumë se gjysmës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij një Komision të drejtimit të punimeve të tij të përbërë nga 5 anëtarë, si dhe një sekretariat teknik, sipas përbërjes së reflektuar në proces-verbalin e punimeve të Kuvendit Kombëtar dhe akteve të tjera të dala prej tij.

Në funksion të verifikimit të ligjshmërisë së vendimeve të marra në Kuvendin Kombëtar të PDSH të datës 11/12/2021, Gjykata vlerëson se duhet të verifikojë procedurën dhe mënyrën e marrjes së vendimve për të cilat kërkohet regjistrimi i tyre, veçanërisht i Vendimit nr.1 dt. 11.12.2021 i cili miraton Statutin e ri të PDSH, dhe më pas edhe 6 vendimarrjet e tjera në vijim, veçanërisht në kushtet kur për miratimin e Vendimit nr 1. Dt. 11.12.2021 baza ligjore dhe procedura e ndjekur janë ato të përshkruara statutin e PDSH të miratuar në Korrik 2021, ndërsa baza ligjore dhe procedura e ndjekur për vendimet e mëpasme është ajo e përcaktuar në statutin e miratuar në mbledhjen e Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021, i cili hyri menjëhërë në fuqi për vullnet të Kuvendit Kombëtar, në mënyrë analoge me statutet e mëparshme të kësaj force politike.

Rezulton nga proces-verbali i mbledhjes së punimeve të Kuvendit Kombëtar, nga materiali i plotë filmik i punimeve të Kuvendit, si dhe nga provat e tjera shkresore, veçanërisht ato të administruara së bashku me vendimin nr. 1 dt.11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar, por edhe ato të provave nr. 2, nr.6 dhe nr.7 të bashkangjitura kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022 se Komisioni i drejtimit të punimeve të Kuvendit, administroi një kërkesë të paraqitur në përputhje me nenet 43, dhe 60 të Statutit të PDSH-së, si më poshtë:

- Kërkesë dhe draft Statutin (ndryshime në Statut) e propozuar nga $\frac{1}{4}$ e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të PDSH, (firmat mbështetëse të 138 anëtarëve të Këshillit Kombëtar sipas provave nr. 2 dhe nr.6) dhe të mbështetura nga 15% e anëtarësisë së Kuvendit Kombëtar (firmat sipas provave nr.7), i cili u regjistrua nga Komisioni me nr. 1, datë 11.12.2021 në proces-verbalin e punimeve të Kuvendit.

Rezulton se ndryshimet ishin hartuar nga propozuesit dhe vinin në formë të reflektimit të tyre në statutin ekzistues, prandaj dispozitat statutore të propozuara për votim ishin drejtpërsëdrejti dispozitat statutore të ndryshuara.

Pavarësisht bashkëlidhjes, te propozimet për ndryshimet statutore, të firmave mbështetëse të anëtarëve të Këshillit Kombëtar dhe delegatëve të Kuvendit, gjithsesi Komisioni për drejtimin e punimeve të Kuvendit fillimisht kërkoi mbështetjen publike të delegatëve të Kuvendit Kombëtar për kërkesën për ndryshime në Statutin e PDSH. Në përputhje me pikën 1, të nenit 19 të Statutit, votimi u bë i hapur duke ngritur dorën ose mandatin dhe duke konfirmuar mbështetjen unanime të delegatëve të Kuvendit Kombëtar për ndryshimet statutore.

Komisioni më pas, hodhi në votim në parim, nen për nen dhe në tërësi ndryshimet në Statutin e PDSH, dhe Kuvendi Kombëtar, me shumicë votash, në praninë e më shumë se gjysmës së anëtarëve të Kuvendit Kombëtar, votoi pro në parim, nen për nen dhe në tërësi ndryshimet në Statut të paraqitura nga një grup anëtarësh të Këshillit Kombëtar të PDSH të cilët përfaqësojnë ¼ e gjithë anëtarësisë së tij, si dhe me mbështetjen e të paktën 15% të delegatëve të Kuvendit Kombëtar të PDSH. Në përputhje me pikën 1, të nenit 19 të Statutit, votimi u bë i hapur duke ngritur dorën ose mandatin.

Vendimarrjet vijuese të Kuvendit Kombëtar të PDSH, konkretisht Vendimet nr.2 – nr.7 u morën sipas parashikimeve të reja staturore të miratuara me vendimin nr. 1 dt.11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar, ashtu si edhe rezultojnë nga proces-verbali i punimeve të Kuvendit si dhe nga materiali i plotë filmik i punimeve të Kuvendit të paraqitur nga kërkuesi me cilësinë e provës.

Gjithashtu me cilësinë e provës, bashkëngjitur kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022, kërkuesi paraqiti edhe provat nr. 20 dhe 21, të cilat konsistojnë në prova shkresore përkatësisht të ngritjes dhe funksionimit të Komisionit të Organizimit dhe Kontrollit të Operacioneve Elektorale të PDSH sipas statutit të miratuar në mbledhjen e dt. 11.12.2021, si dhe Vendimin nr.5 me nr. Prot.12 dt.19/12/2021, miratuar nga Komisioni i Organizimit dhe Kontrollit të Operacioneve Elektorale. Ky i fundit ka bashkëngjitur edhe tabelën e rezultateve përfundimtare të referendumit të ratifikimit të Vendimit nr. 6 dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar, për shkarkimin e z. Lulzim Basha nga funksioni i Kryetarit të PDSH.

Provat e mësipërme perfeksionojnë ligjërisht dhe nga pikëpamja staturore Vendimin nr. 6. dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të PDSH, pasi për vullnet të shprehur të këtij organi, dhe bazuar mbi statutin e PDSH, kjo vendimarrje ishte përcaktuar për tu miratuar me referendum nga gjithë anëtarësia e PDSH.

Përsa më sipër gjykata vlerëson se procedurat e ndjekura për propozimin dhe miratimin e vendimeve të Kuvendit Kombëtar të PDSH të datës 11.12.2021, janë në përputhje të plotë me parashikimet staturore në fuqi në momentin e miratimit të tyre, dhe praktika dokumentare shoqëruese e këtyre vendimarrjeve është e plotë dhe e pakontestueshme.

Vendimet e marra në Kuvendin Kombëtar të PDSH të datës 11.12.2021 janë vendime të marra në përputhje të plotë me tagrin dhe kompetencat staturore të Kuvendit Kombëtar të PDSH, si organi më i lartë vendimarrës i kësaj force politike dhe si të tilla ato duhet të regjistrohen në regjistrin e partive politike.

Vendimet e mësipërme përcaktojnë edhe ndryshime thelbësore në formatimin dhe përbërjen e organeve qendrore drejtuese të PDSH dhe si të tilla përmbajtja e tyre duhet të reflektohet përkatësisht edhe në përbërjen e organeve qendrore drejtuese të PDSH të regjistruara në regjistrin e partive politike.

Përsa më sipër gjykata duke e gjetur të bazuar në ligj e në prova kërkesën e palës kërkuese vendosi pranimin e saj duke vendosur :

PËR KËTO ARËSYE

Gjykata, në bazë të ligjit nr.8580, datë 07.02.2000 "Për Partite Politike"

VENDOSI:

1.Pranimin e kerkeses se pales kerkuese Partia Domokratike e Shqiperise, perfaqesuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit të P.D.SH.

2.Depozitimim e vendimeve te kuvendit Kombetar te PDSH duke rregjistruar ndryshimet perkatese ne regjistrin e partive politike:

Vendimin nr 1. dt.11.12.2021, me anekset bashkëlidhur Statutin e Partisë Demokratike, të Kuvendit Kombëtar të Partisë

Vendimin nr 2. dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike

Vendimin nr 3. dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike

Vendimin nr 4. dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike

Vendimin nr 5. dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike

Vendimin nr 6. dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike

Vendimin nr 7. dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike

3.Kunder ketij vendimi mund te behet ankim sipas ligjit.

U shpall sot ne Tirane me date 25.03.2022.

SEKRETARE

ORNELAMARASHI

GJYQITAR

AGRON ZHUKRI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER LAURA L. PUSTINA



DATE 02/02/2023
NR REP 218



VËRTETIM NJËSIE ME ORIGINALIN

Sot, më datë 02/02/2023, para meje Noteres LAURA L. PUSTINA, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Njesia Administrative n. 5, Rr. Abdyl Frasheri, P. nr. 31, Ap. 6, katë 3, u paraqit personalisht:

KËRKUES/IT: Ivi Kaso, atësia Spiro, amësia Loreta, shtetas Shqiptar, lindur në Përmet dhe banues në TIRANË, me adresë Faik Konica; Nd. 21; H. 2; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1010; Tiranë, lindur më 11/03/1979, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033944850 dhe nr. personal H90311124P, i cili me paraqiti dokumentin origjinal:

Vendim i Gjyqates se Rrethit Gjyqesor Tirane, nr. 1346 / 222 Akti, date 15.12.2021 Regj., Nr. 3 Vendimi, date 25.03.2022 Vendimi.


Unë Noterja, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezultoi se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "I", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noteres, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

LAURA L. PUSTINA





Partia
Demokratike

KOMISIONI I PËRKOHSHËM I RITHEMELIMIT TË PDSH

Nr. 04 Prot.

Tiranë, më 16 . 12 . 2021

VENDIM

Nr. 1

**“Për ngritjen e Komisionit të Organizimit dhe Kontrollit të Operacioneve
Elektorale”**

Në mbështetje të nenit 11, 53 dhe 64, të Statutit të PDSH-së, si dhe në zbatim të vendimit nr. 06, datë 11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike, Komisioni i Ritthemelimit në mbledhjen e datës 13.12.2021,

VENDOSI

1. Ngritjen e Komisionit të Organizimit dhe Kontrollit të Operacioneve Elektorale, me qëllim organizimin dhe drejtimin e procesit të Referendumit të datës 18.12.2021, me këtë përbërje:
 - Albana Vokshi- Kryetar
 - Ervin Minarolli- Anëtar
 - Enno Bozdo- Anëtar
 - Edith Harxhi- Anëtar
 - Keltis Kruja- Anëtar
2. Komisioni i Organizimit dhe Kontrollit të Operacioneve Elektorale, ushtron detyrat sipas nenit 53 të statutit të Partisë Demokratike të Shqipërisë, dhe ka përgjegjësinë të organizojë, mbikëqyrë dhe drejtojë procesin referendar të datës 18.12.2021 deri në nxjerrjen dhe shpalljen e rezultatit përfundimtar të tij, nga ky komision.

KOMISIONI I PËRKOHSHËM I RITHEMELIMIT TË PDSH

Stamur Noka EDI PALOKA

Arben Rizdani

Edith Harxhi





ERVIN MINAROLLI
eltis kruje

[Handwritten signature]

Geut Shaukur

[Handwritten signature]

Aldo Buma

[Handwritten signature]

Emir Basha

[Handwritten signature]

Edrit Harxhi

[Handwritten signature]

Oerd Bylyk

[Handwritten signature]

Armando Hajdari

[Handwritten signature]

Alban Kallm

[Handwritten signature]

Levi Angelini

[Handwritten signature]

Plendi Arifi

[Handwritten signature]

Genç Follsi

[Handwritten signature]

Edmond Sali

Georgi Mendi

Imir Kasa

[Handwritten signature]

ISHQIPËRIJA.COM





Partia Demokratike

KOMISIONIN E ORGANIZIMIT DHE KONTROLLIT TË OPERACIONEVE
ELEKTORALE

Nr. 80 Prot.

Date 27. 05. 2022


VENDIM Nr. 21

Komisioni i Organizimit dhe Kontrollit të Operacioneve Elektorale, mbledhur ditën e enjte, datë 26 maj 2022, në prani të përfaqësuesve të dy kandidatëve për Kryetar, bëri hapjen e kutive të votimit ardhura nga degët.

Pas verifikimit të procesverbaleve origjinale, KOKOE, shpall rezultatin për cdo degë si më poshtë vijon:

Nr.	Dega	S. BERISHA	I. ELEZI	TE PAVLEFSHME	TOTAL
1	Kukës	714	164	4	882
2	Has	803	22	5	830
3	Tropojë	914	2	-	916
4	Shkodër	1,500	114	15	1,629
5	Vau i Dejës	726	95	2	823
6	Malësi e Madhe	593	45	1	639
7	Pukë	232	49	4	285
8	Fush Arrez	244	8	2	254
9	Diber	664	84	6	754
10	Bulqize	431	17	8	456
11	Mat	919	40	12	971
12	Lezhë	859	39	8	906
13	Mirditë	454	18	6	478
14	Kurbin	1,057	128	3	1,188
15	Durrës	1,582	161	18	1,761
16	Shijak	465	13	-	478
17	Kruje	523	14	1	538
18	Fushë-Krujë	447	11	12	470
19	Elbasan	1,020	39	7	1,066
20	Cërrik	337	14	6	357
21	Gramsh	353	17	2	372





Partia Demokratike

KOMISIONIN E ORGANIZIMIT DHE KONTROLLIT TË OPERACIONEVE ELEKTORALE

22	Peqin	335	5	2	342
23	Prrenjas	200	7	-	207
24	Belsh	283	12	2	297
25	Librazhd	401	8	1	410
26	Korçë	621	36	8	665
27	Pogradec	484	32	-	516
28	Kolonjë	356	38	-	394
29	Devoll	1,082	135	8	1,225
30	Maliq	1,266	10	2	1,278
31	Berat	378	57	6	441
32	Kuçovë	437	45	1	483
33	Poliçan	93	2	-	95
34	Skrapar	91	8	3	102
35	Ura-Vajgurore	305	28	14	347
36	Fier	2,170	46	18	2,234
37	Lushnjë	733	73	9	815
38	Patos	614	11	1	626
39	Mallakastër	409	10	-	419
40	Roskovec	429	39	4	472
41	Divjake	320	34	-	354
42	Gjirokastër	1,018	21	10	1,049
43	Këlcyrë	188	33	1	222
44	Memaliaj	193	33	1	227
45	Përmet	206	33	4	243
46	Tepelenë	153	6	-	159
47	Vlorë	836	46	8	890
48	Selenicë	196	22	1	219
49	Delvinë	207	14	-	221
50	Sarandë	354	121	11	486
51	Himare	113	9	2	124
52	Tirana 1	626	13	2	641
53	Tirana 2	693	31	10	734
54	Tirana 3	519	21	6	546
55	Tirana 4	463	4	4	471
56	Tirana 5	501	21	2	524
57	Tirana 6	626	14	2	642



Partia Demokratike

KOMISIONIN E ORGANIZIMIT DHE KONTROLLIT TË OPERACIONEVE ELEKTORALE

58	Tirana 7	397	13	6	416
59	Tirana 8	681	22	4	707
60	Tirana 9	700	12	3	715
61	Tirana 10	250	13	2	265
62	Tirana 11	836	21	7	864
63	Tirana 12	166	3	1	170
64	Tirana 13	223	11	1	235
65	Tirana 14	456	40	8	504
66	Tirana 15	266	2	-	268
67	Tirana 16	294	21	4	319
68	Kamëz	1,284	68	10	1,362
69	Paskuqan	911	40	5	956
70	Kavajë	830	23	5	858
71	Rrogozhinë	440	29	1	470
72	Vore	346	42	-	388
	TOTAL	40,816	2,532	322	43,670

Duke konsideruar sa më sipër, e në zbatim të nenit nr. 53 të Statutit të Partisë Demokratike, Komisioni i Organizimit dhe Kontrollit të Operacioneve Elektorale

Vendosi:

1. Shpalljen e z. Sali Berisha, Kryetar të Partisë Demokratike të Shqipërisë.
2. Ky vendim mund të ankimohet, pranë KOKOE-s, brenda 5 ditëve nga momenti i shpalljes së rezultatit.

KOMISIONI I ORGANIZIMIT DHE KONTROLLIT TË OPERACIONEVE ELEKTORALE

Kryetare
Albana Vokshi

Anëtarë:

Ervin Minarolli

Enno Bozdo

Keltis Kruja

Edith Harxhi



Tiranë më 11.12.2021

Lënda: Propozim për vendimarrje Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të datës 11.12.2021

Drejtuar: Komisionit të drejtimit të punimeve të Kuvendit Kombëtar

Të nderuar anëtarë të Komisionit të drejtimit të punimeve të Kuvendit Kombëtar,

Në zbatimin të parashikimeve të nenit 42 dhe 43 të Statutit të PDSH, një grup prej të paktën 7 deputetësh, sipas firmave bashkëlidhur, i propozojnë për miratim mbledhjes së Kuvendit Kombëtar projekt vendimet bashkëlidhur.

Për paraqitjen dhe relatimin e tyre, përpara mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, ngarkojmë për përfaqësim deputetin z. Belind Këlliçi.

Deputetët

Arif R. Bylykaj
BELIND KËLLIÇI *Belind Këlliçi*
Edmond Spata
Stamur Noka
EDI PALOKA
ISUF ÇEKI
ALBANA VOKSHI



KUVENDI KOMBËTAR I PARTISË DEMOKRATIKE
11.12.2021

VENDIM
NR. 02 DT 11.12.2021

Në mbështetje të nenit 42 dhe 43/1/d të Statutit të Partisë Demokratike të Shqipërisë, miratuar në datën 11.12.2021, me propozimin e një grupi prej 7 deputetësh të PD, Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike

VENDOSI

1. Shpalljen e z.Azem Hajdari, Kryetar Nderi i Partisë Demokratike të Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Komisioni i Drejtimit të Punimeve të Kuvendit



[Handwritten signatures]



KUVENDI KOMBËTAR I PARTISË DEMOKRATIKE
11.12.2021

VENDIM
NR. 03 DT 11.12.2021


Në mbështetje të nenit 42 dhe 43 të Statutit të Partisë Demokratike të Shqipërisë, miratuar në datën 11.12.2021, me propozimin e një grupi prej 7 deputetësh të PD, Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike

VENDOSI

1. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të zgjedhjes, në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të datës 30.08.2021, të Nënkryetarëve të Partisë Demokratike të Shqipërisë, të Sekretarit të Përgjithshëm dhe Sekretarëve funksionalë të saj, të Kryetarit të Komisionit të Apelimit, Integritetit dhe Etikës, dhe të Kryetarit të Komisionit Zgjedhor të Partisë, si të zgjedhur në kundërshtim flagrant me nenin 44 të Statutit të PD në fuqi në kohën e mbajtjes së mbledhjes.
2. Ndalimin e tyre për ushtrimin e detyrave përkatëse si të paligjshëm në ato funksione.
3. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të mbledhjes së konstituimit të Kryesisë së Partisë Demokratike të Shqipërisë të datës 15.11.2021 për shkak të pjesëmarrjes në të të personave të pa zgjedhur sipas dispozitave statutore dhe të mungesës së kuorumit dhe legjitimitetit për t'u mbledhur.
4. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr 139 datë 15.11.2021 të Kryesisë së PDSH si vendim i marrë nga një organ i pakonstituuar, në mungesë të kuorumit dhe në kundërshtim flagrant me dispozitat statutore, përkatësisht nenet 43 dhe 45 të statutit të PDSH në fuqi në momentin e marrjes së tij,
5. Anullimin e thirrjes publike dhe të njoftimit të degëve të PDSH për mbajtjen e Kuvendit Kombëtar të PDSH në datën 18.12.2021 ora 11.00, sipas vendimit nr 139 datë 15.11.2021 të Kryesisë së PDSH.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Komisioni i Drejtimit të Punimeve të Kuvendit









KUVENDI KOMBËTAR I PARTISË DEMOKRATIKE
11.12.2021

VENDIM
NR. 04 DT 11.12.2021

Në mbështetje të nenit 42, 43 dhe 64 të Statutit të Partisë Demokratike të Shqipërisë, miratuar në datën 11.12.2021, me propozimin e një grupi prej 7 deputetësh të PD, Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike

VENDOSI

1. Ngritjen e Komisionit të Rithemelimit të Partisë Demokratike të Shqipërisë me përbërje si me poshtë:

- Agron Shehaj
- Albana Vokshi
- Aldo Bumçi
- Arben Ristani
- Belind Këlliçi
- Blendi Himçi
- Bujar Nishani
- Çlirim Gjata
- Edith Harxhi
- Edi Paloka
- Edmond Spaho
- Enno Bozdo
- Ervin Minarolli
- Evi Kokalari
- Flamur Noka
- Gene Deromemaj
- Gene Pollo
- Genti Strazimiri
- Grigels Muçollari
- Ivi Kaso



(Handwritten signatures of the seven members of the Commission)

-Keltis Kruja
-Klevis Balliu
-Ledina Mandia
-Luan Baçi
-Lorenc Luka
-Mimoza Hajdarmataj
-Oerd Bylykbashi
-Sali Berisha
-Tritan Shehu

2. Organet qendrore të partisë, përveç Kuvendit Kombëtar, ndalohet të ushtrjnë kompetencat e tyre staturore deri në përfundim të mandatit të Komisionit të Rithemelimit të PD sipas nenit 64 të Statutit të Partisë Demokratike. Çdo vendimarrje e tyre në kundërshtim me këtë vendim dhe me nenet 64 dhe 65 të Statutit të PDSH është absolutisht e pavlefshme.
3. Komisioni i Rithemelimit të Partisë Demokratike është përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi dhe për marrjen e masave të nevojshme për aplikimin e statutit të PDSH të miratuar në mbledhjen e Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021 në të gjitha nivelet e organizimit të PDSH.
4. Komisioni i Rithemelimit të Partisë Demokratike është përgjegjës për organizimin dhe fillimin e proceseve referendare e zgjedhore në PDSH sipas radhës së përcaktuar në statut dhe të diktuar nga nevojat e funksionimit politik normal të PDSH.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Komisioni i Drejtimit të Punimeve të Kuvendit




KUVENDI KOMBËTAR I PARTISË DEMOKRATIKE
11.12.2021

VENDIM
NR. 05 DT 11.12.2021




Në mbështetje të nenit 42, 43 dhe 63 të Statutit të Partisë Demokratike të Shqipërisë, miratuar në datën 11.12.2021, me propozimin e një grupi prej 7 deputetësh të PD, Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike

VENDOSI

1. Thirrjen e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë në datën 22.03.2022, me qëllim rishikimin e Statutit të Partisë Demokratike të PDSH dhe zgjedhjes së organeve qendrore të PDSH sipas statutit.
2. Rendi i ditës, ora dhe vendi i mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, sipas pikës 1, do të përcaktohen me anë të një njoftimi publik të Komisionit të Rithemelimit të PDSH jo më vonë se 30 ditë përpara datës së mbledhjes së Kuvendit.
3. Për përpunimin dhe reflektimin e të gjitha propozimeve statutore në një projekt të përbashkët, i cili do t'i paraqitet për miratim mbledhjes së Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të datës 22.03.2021, ngrihet komisioni i posaçëm i ndryshimeve statutore, me përbërje që do të përcaktohet me vendim të Komisionit të Rithemelimit të PDSH.
4. Komisioni bën publik projektin e ndryshimeve statutore si dhe një relacion përmbledhës të punës së tij të paktën një javë përpara datës së mbledhjes së Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të datës 22.03.2021. Ky material bëhet pjesë e dosjes së punës së delegatëve të Kuvendit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Komisioni i Drejtimit të Punimeve të Kuvendit

KUVENDI KOMBËTAR I PARTISË DEMOKRATIKE
11.12.2021

VENDIM
NR. 06 DT 11.12.2021

Në mbështetje të nenit 43/ç të Statutit të Partisë Demokratike të Shqipërisë, miratuar në datën 11.12.2021, me propozimin e një grupi prej 7 deputetësh të PD, si dhe të të paktën 15 përqind të delegatëve të Kuvendit, Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike,

VENDOSI

1. Të votojë me votim të fshehtë të delegatëve për shkarkimin e Kryetarit të Partisë Demokratike z. Lulzim Basha, për thyerje të rënda të Statutit të Partisë Demokratike, përvetësim të kompetencave të organeve qendrore të Partisë Demokratike dhe dëmtim të rëndë të interesave politike dhe elektorale të saj. Votimi të kryhet gjatë zhvillimit të punimeve të Kuvendit të datës 11.12.2021.
2. Fleta e votimit sipas pikës 1 të këtij vendimi të përmbajë pyetjen: “A jeni dakord me shkarkimin e kryetarit të PDSH Lulzim Basha?”. Fleta e votimit të përmbajë përgjigjet alternative: “PO (dakort me shkarkimin)” dhe “JO (kundër shkarkimit)”
3. Vendimarrja e dalë nga votimi i Kuvendit Kombëtar sipas pikës 1 të këtij vendimi të ratifikohet nëpërmjet një referendumi në të gjithë anëtarësinë e PDSH, i cili do të mbahet në datën 18.12.2021 në të gjitha degët e Partisë Demokratike.
4. Fleta e votimit në referendum sipas pikës 3 të përmbajë pyetjen: “A jeni dakord me vendimin e Kuvendit Kombëtar për shkarkimin e kryetarit të PDSH Lulzim Basha?”. Fleta e votimit në referendum të përmbajë përgjigjet alternative: “PO (dakort me shkarkimin)” dhe “JO (kundër shkarkimit)”.

Ky vendim miratohet me votim të hapur dhe hyn në fuqi menjëherë

Komisioni i Drejtimit të Punimeve të Kuvendit



KUVENDI KOMBËTAR I PARTISË DEMOKRATIKE
11.12.2021

VENDIM
NR. 07 DT 11.12.2021

Në mbështetje të nenit 42 dhe 43 të Statutit të Partisë Demokratike të Shqipërisë, miratuar në datën 11.12.2021, me propozimin e një grupi prej 7 deputetësh të PD, Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike

VENDOSI

1. Të autorizojë Komisionin e Përkohshëm të Rithemelimit të PDSH për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të regjistrimit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të ndryshimeve statutore dhe statutit të ri të PDSH, të vendimeve të Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021 si edhe të gjithë praktikës dokumentare përkatëse lidhur me punimet e Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Komisioni i Drejtimit të Punimeve të Kuvendit



[Handwritten signatures in blue ink]

[Handwritten signature in blue ink]

[Handwritten signature in blue ink]





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

NJOFTIM
PËR MEDIAN DHE PUBLIKUN

Në vijim të informacioneve të dhëna më herët dhe në respekt të së drejtës së publikut për tu informuar mbi çështjet me interes publik dhe posaçërisht proceset mbi kërkesat për regjistrim në regjistrin e partive politike për subjektin Partia Demokratike e Shqipërisë, ju njoftojmë sa më poshtë :

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me trup gjykues të përbërë nga gjyqtar Agron Zhukri, me vendimin nr.3, të datës 25.03.2022, ka vendosur:

“1.Pranimin e kërkesës së palës kërkuese Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit të P.D.SH.

2.Depozitimin e vendimit të Kuvendit Kombëtar të PDSH duke rregjistruar ndryshimet përkatëse në regjistrin e partive politike:

Vendimin nr 1, dt.11.12.2021 me anekset bashkëlidhur Statutin e Partisë Demokratike, të Kuvendit Kombëtar të Partisë.

Vendimin nr 2, dt.11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike.

Vendimin nr 3, dt.11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike.

Vendimin nr 4, dt.11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike.

Vendimin nr 5, dt.11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike.

Vendimin nr 6, dt.11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike.

Vendimin nr 7, dt.11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike.

3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit.

Në datë 04.04.2022, kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Partia Demokratike e Shqipërisë përfaqësuar nga z. Enkelejd Alibeaj, me të cilin është kërkuar :

“Prishja e Vendimit Nr. 1346/222 Akti Nr. 3 Vendimi, datë 25.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me gjyqtar Agron Zhukri duke vendosur pushimin e gjykimit ose kthimin e saj për shqyrtim në të njëjtën gjykatë por me tjetër trupë gjykuese”.

Ne lidhje me ankimin e mësipërm është shqyrtuar në Gjykatën e Shkallës të Parë “Disponimi i ankimit” dhe me **vendimin nr. 508 Regj. Them, datë 22.04.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me gjyqtare Blerina Muça** ka vendosur:

“- Pranimin e ankimit të palës ankuese, Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Nënkryetari i saj z. Enkelejd Alibeaj, ndaj Vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në datë 16.05.2022, u depozituan në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë :

(i) Apel kundërshtues në emër të Partisë Demokratike, përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit dhe me autorizim nga Z. Ivi Kaso, me të cilin është kërkuar mospranimi i ankimit të bërë nga Z. Enkelejd Alibeaj datë 04.04.2022;

(ii) Ankimi në emër të Partisë Demokratike, përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit dhe me autorizim nga Z. Ivi Kaso, kundër vendimit nr. 508 Regj. Them, datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin kërkohet prishja e këtij vendimi, duke vendosur mospranimin e ankimit të palës ankuese Partia Demokratike e Shqipërisë, të përfaqësuar nga nënkryetari Z. Enkelejd Alibeaj, ndaj vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Çështja në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, u shqyrtua sot më datë 03.03.2023 ora 11:00. Trupi gjykues përbëhet nga : Relatore Gjyqtare znj. Elona Mihali dhe anëtarë z. Astrit Kalaja dhe znj. Irida Kacerja, trup gjykues i caktuar me shortin elektronik të datës 03.02.2023.

Që në fillim të seancës gjyqësore, pala kërkuese përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit parashtroi si kërkesë paraprake kërkesën për mopranimin e ankimit të paraqitur

nga PDSH, përfaqësuar nga nënkryetari Enkelejd Alibeaj me Autorizim, ndaj vendimit nr. 3 datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak mungese legjitimitimi në paraqitjen e ankimit. Sipas kësaj kërkesë të palës kërkuese, ankuesi PDSH , përfaqësuar nga nënkryetari Enkelejd Alibeaj me Autorizim, nuk ka të drejtë për të bërë ankim dhe për të qënë pjesë e procesit gjyqësor.

Kundrejt këtij pretendimi, përfaqësuesi i ankuesit PDSH, përfaqësuar nga nënkryetari Enkelejd Alibeaj me Autorizim u shpreh se tërheq të drejta në këtë proces gjyqësor dhe i takon të bëjë ankim ndaj vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Sipas nenit 15 të Ligjit ‘Për partitë politike’.

Trupa gjykuese u tërhoq për të marrë vendim të ndërmjetëm dhe pas konsultimit, u vendos që në lidhje me këtë kërkesë, Gjykata do të shprehej pasi të shqyrtonte ankimin dhe apelin kundërshtues.

Në vijim të seancës, pati debat gjyqësor duke paraqitur parashtime shtesë me shkrim dhe realizuar pyetje palët ndaj njëra-tjetrës.

Pala kërkuese e këtij gjykimi PDSH përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit kishte ushtruar njëkohësisht *apel kundërshtues* dhe gjithashtu *ankim ndaj vendimit për disponimin e ankimit nr. 508 Regj.Them, datë 22.04.2022*, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në përfundim pala kërkuese kërkoi: *Mospranimin e ankimit ndaj vendimit nr. 3, të datës 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ose rrëzimin e ankimit.*

Pala ankuese PDSH përfaqësuar nga Nënkryetari Enkelejd Alibeaj me autorizim kërkoi: *Prishjen e vendimit nr. 3, të datës 25.03.2022 dhe pushimin e gjykimit ose në alternativë, prishjen e vendimit nr. 3, të datës 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues.*

Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e përbërë nga trupi gjykues me Relatore znj. Elona Mihali dhe anëtarë z.Astrit Kalaja dhe znj. Irida Kacerja, **me unanimitet, me vendimin nr. 44, datw 03.03.2023, vendosi:**

- 1) Mospranimin e ankimit të ankuesit Partia Demokratike të Shqipërisë përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, të ushtruar ndaj vendimit nr. 508 rregj them, datë vendimi 22.04.2022 me objekt “Disponim ankimi” të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si vendim ndaj të cilit nuk lejohet ankim.
- 2) Prishjen e vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dergimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate me tjetër trup gjykues.
- 3) Kundër këtij vendimi lejohet rekurs i veçantë në Gjykatën e Lartë brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Tiranë, 03.03.2023

GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

[shqiptarja.com]

[\(https://pd.al/\)](https://pd.al/)

Kerko



Menu

Statuti i Partise Demokratike



KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Emri

Partia mban emrin Partia Demokratike e Shqipërisë dhe akronimin zyrtar PD.

Neni 2

Vlerat themelore politike

1. Partia Demokratike e Shqipërisë (në vijim: PDSH) është parti politike që bashkon në gjirin e saj shtetasit shqiptarë, brenda dhe jashtë vendit, që besojnë, respektojnë dhe mbrojnë:

- lirinë dhe demokracinë;
- ndërtimin e shtetit të së drejtës, demokratik e social, që garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, dinjitetin dhe personalitetin njerëzor, si dhe prosperitetin e të gjithë kombit;
- vlerat themelore të familjes tradicionale në shoqëri;
- shenjtërinë e pronës private;
- dekomunistizimin e shoqërisë shqiptare si një mision i vazhdueshëm;
- humanizimin e solidaritetin shoqëror dhe frymën e tolerancës e të bashkëjetesës fetare;
- vlerat, parimet dhe detyrimet e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s;
- aspiratën për integrimin e plotë europian të Shqipërisë, nëpërmjet jetësimit të dëshirës së përhershme, qasjes perëndimore dhe thirrjes së brendshme të anëtarëve të saj "Ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Europa";
- drejtësinë, paqen, harmoninë dhe bashkëpunimin ndërmjet kombeve, si vlerat më të larta të njerëzimit.

2. PDSH-ja promovon në interes të Shqipërisë dhe shqiptarëve:

- të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;
- zhvillimin e nismës së lirë e barazinë në shanse, tregun e lirë e konkurrencën si mjet të zhvillimit të shpejtë dhe të qëndrueshëm të vendit;
- sigurinë e individit e të pronës;
- drejtësinë shoqërore e dialogun social;
- paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror;
- pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, rendin kushtetues, pluralizmin, identitetin kombëtar dhe trashëgiminë kombëtare;
- ruajtjen e natyrës dhe të mjedisit;
- autoritetin e shtetit dhe vetëqeverisjen lokale;
- meritokracinë dhe shanset e barabarta në punësim dhe karrierë, duke nxitur një administratë publike të qëndrueshme dhe profesionale;
- luftën ndaj korrupsionit dhe dhënies fund të fenomenit të pandëshkueshmërisë;
- shkëputjen e lidhjeve midis politikës dhe krimit të organizuar, përmes dekriminalizimit të plotë të jetës politike dhe

qendrore të PDSH-së, si dhe strukturat e saj ekzekutive, kujdesen për marrjen në mbrojtje të anëtarëve, simpatizantëve dhe mbështetësve të tyre nga çdo pasojë e mundshme që rrjedh prej pjesëmarrjes në veprimtarinë politike të kryer në përputhje me këtë Statut, apo bindjeve të tyre politike.

Neni 10

E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur

1. Çdo anëtar që përmbush kushtet e parashikuara në këtë Statut, apo kriteret e posaçme për një funksion partiak të caktuar, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. Vota e çdo anëtari është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.
2. Organizimi i brendshëm i partisë bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, dhe periodike. Mandati i organeve në PDSH dhe organizatave të saj partnere, është katër vjet.
3. Sistemi zgjedhor brenda partisë, garanton parimin e konkurrimit të lirë dhe shanseve të barabarta midis kandidatëve, sipas kriterëve të shpallura dhe të njohura paraprakisht. Kandidatëve për çdo organ të partisë u garantonet e drejta e barabartë në procesin zgjedhor dhe kontrollin mbi mënyrën e realizimit të tij. Realizimi i çdo procesi zgjedhor brenda partisë udhëhiqet nga parimet demokratike dhe transparenca.
4. Karriera e çdo anëtari dhe/ose simpatizanti të PDSH-së, në funksionet brenda organeve të partisë apo funksionet politike përfaqësuese dhe/ose shtetërore, bazuar në meritokracinë dhe kontributin politik, elektorale dhe profesional të tij, është e garantuar. Zgjedhja apo caktimi në këto funksione bëhet bazuar në kohëzgjatjen e anëtarësimit në parti apo shfaqjes si simpatizant i saj; kontributit në fushata elektorale; kontributit profesional e politik në parti, si dhe në promovimin e vlerave themelore që udhëheqin PDSH-në; aktivizimit në jetën politike e publike të vendit; mbrojtjes në vazhdimësi të interesave, vlerave dhe programit të PDSH-së; si dhe reputacionit në radhët e anëtarësisë dhe/ose shoqërisë në tërësi.
5. Si rregull, kur kjo është e zbatueshme sipas Statutit, në çdo organ të partisë, numri i anëtarëve të zgjedhur duhet të jetë më i madh se numri i atyre që hyjnë drejtpërdrejt si anëtarë të organit për shkak të funksionit të tyre.
6. Rregullat e hollësishme për të garantuar të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, kriteret e posaçme për çdo funksion politik brenda partisë apo për përfaqësimin politik në organet qendrore apo lokale, si dhe rregullat që garantojnë një proces zgjedhor demokratik dhe transparent, përcaktohen në aktet nënstatutore.

Neni 11

Llogaridhënia dhe vlerësimi i performances

1. Organet e partisë dhe funksionarët politikë të PDSH-së japin llogari në mënyrë periodike për punën e tyre përpara organeve të tjera drejtuese të partisë, sipas hierarkisë, si dhe përpara anëtarëve të PDSH-së, sa herë kërkohet nga më shumë se 1/4 e tyre, sipas organizimit dhe nivelit të përfaqësimit.
2. Organet e partisë dhe funksionarët politikë të PDSH-së detyrohen të marrin dhe të parashirojnë mendimin e zgjedhësve të tyre, përfshirë dhe mendimin ndryshe, si dhe raportojnë përgjigjen përpara tyre për vendimet e marra dhe veprimtarinë e tyre.
3. Anëtarët e PDSH-së, organet e partisë dhe funksionarët politikë të PDSH-së i nënshtrohen procesit periodik të vlerësimit të performancës dhe kontributit, nëpërmjet analizës dhe diskutimit të hapur me anëtarët, apo sondazheve të organizuara nga PDSH-ja, sipas organizimit dhe nivelit të pjesëmarrjes apo përfaqësimit. Vlerësimi periodik i performancës dhe kontributit mbahet në konsideratë gjatë ecursisë në karrierë të tyre brenda organeve të partisë apo funksioneve përfaqësuese politike.
4. Rregullat e hollësishme për të garantuar llogaridhënien dhe vlerësimin e performancës përcaktohen në aktet nënstatutore.

Neni 12

Zgjedhja e funksionarëve politikë, në nivel qendror apo lokal

1. Demokracia e brendshme dhe kolegjaliteti zbatohet edhe në përcaktimin e kandidaturave elektorale të partisë. Anëtarët e partisë kanë të drejtën e identifikimit dhe propozimit të kandidaturave të mundshme elektorale, sipas rregullave dhe kushteve të përcaktuara në aktet nënstatutore.
2. Kandidaturat për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë seleksionohen në bashkëpunim dhe konsultim aktiv me anëtarët e PDSH-së. Pas konsultimit me anëtarësinë, me propozim të Kryetarit të Partisë, Kryesia e PDSH-së vendos listën përfundimtare të kandidaturave elektorale për Kuvendin e Shqipërisë. Kjo listë i paraqitet për miratim Këshillit Kombëtar të PDSH-së.
3. Kandidaturat për zgjedhjet në pushtetin vendor seleksionohen në bashkëpunim dhe konsultim aktiv me anëtarët e PDSH-së. Pas konsultimit me anëtarësinë, kandidaturat për organet ekzekutive të pushtetit vendor propozohen nga Kryetari i Partisë, caktohen nga Kryesia e PDSH-së dhe lista e plotë miratohet nga Këshilli Kombëtar. Kryesitë e Degëve vendosin për kandidaturat e këshilltarëve në njësitë vendore. Kryesia e PDSH-së duhet të informohet për çdo hap të

2. Në rast se në mbledhje nuk janë të pranishëm anëtarët e nevojshëm për të siguruar shumicën e kërkuar për vendimmarrje, drejtuesi i mbledhjes nuk duhet të fillojë mbledhjen dhe njofton shtyrjen e mbledhjes për një datë dhe orë tjetër. Në këtë rast, ai mund të mos marrë parasysh afatet e përcaktuara në Statut. Mbledhja tjetër është në çdo rast me aftësi vendimmarrëse dhe kjo u njoftohet anëtarëve sëbashku me datën dhe orën e mbledhjes tjetër. Nëse mungesa e numrit të nevojshëm të anëtarëve për marrjen e vendimit gjatë mbledhjes vërtetohet në çastin e votimit, atëherë votimi shtyhet për në një mbledhje tjetër.

3. Në përcaktimin e numrit të nevojshëm për të siguruar aftësinë vendimmarrëse llogariten edhe abstenimet dhe/ose votat e pavlefshme.

Neni 18

Shumica e kërkuar për vendimmarrje

1. Vendimet miratohen me shumicën e votave të vlefshme të pjesëmarrësve në votim, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2 dhe 3 të këtij neni. Kur votat janë të barabarta propozimi i votuar konsiderohet i refuzuar.

2. Për ndryshime statutores nevojitet shumica e të gjithë anëtarëve me të drejtë vote.

3. Për miratimin e vendimit për shpërndarjen apo bashkimin e PDSH-së me një parti tjetër, duhet një shumicë prej 3/4 e votave.

Neni 19

Llojet e votimit

1. Votimi bëhet i hapur duke ngritur dorën ose mandatin.

2. Votimi bëhet i fshehtë vetëm në rastet e përcaktuara nga Statuti, si edhe kur propozimi për votim të fshehtë mbështetet nga 1/6 e anëtarëve me të drejtë vote. Format e votimit të fshehtë përcaktohen në aktet nënstatutores.

Neni 20

Afatet e zgjedhjeve

Të gjitha organet e Partisë duhet t'u nënshtrohen zgjedhjeve periodike të paktën çdo katër vjet.

Neni 21

Dokumentimi i vendimeve

1. Vendimet e Kuvendit Kombëtar, të Këshillit Kombëtar, të Kryesisë së PDSH-së, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e Kryetarit të Partisë apo Sekretarit të Përgjithshëm, dokumentohen, protokollohen dhe arkivohen sipas rregullave të përcaktuara nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Për dokumentimin dhe njoftimin e vendimeve të organeve vendore të Partisë, është përgjegjës Sekretari i Degës.

Vendimet e organeve vendore të Partisë dokumentohen, protokollohen dhe arkivohen sipas rregullave të përcaktuara nga Sekretari i Përgjithshëm.

KREU III

ANËTARËSIA

Neni 22

Kushtet e anëtarësisë

1. Anëtar i PDSH-së mund të jetë, çdo shtetas shqiptar që:

a) është mbi 15 vjeç;

b) pranon kushtet e anëtarësimin dhe përkrah e mbron vlerat themelore të PDSH-së;

c) nuk është anëtar i partive politike, apo i organizatave që nuk janë në partneritet të deklaruar e pranuar nga PDSH-ja.

2. Kërkesa për anëtarësim duhet të paraqitet me shkrim duke plotësuar formularin përkatës:

a) pranë Seksionit të Partisë ku kërkuesi ka banimin;

b) pranë Degës së Partisë ku kërkuesi ka banimin;

c) pranë selisë qendrore të PDSH-së, e cila ia përcjell Degës ku kërkuesi ka banimin;

3. Pranimi në seksionin apo degën e PDSH-së bëhet vetëm për anëtarët që banojnë në territorin përkatës, nëpërmjet regjistrimit të anëtarit në sistemin elektronik të antarësisë nga Dega e PDSH-së dhe pajisjes së tij me dokumentin e antarësisë.

4. Në rast refuzimi të kërkesës, personi mund të ankohet në organin epror më të afërt të organit që ka hedhur poshtë kërkesën për regjistrim, vendimi i të cilit mund të ankimohet në Komisionin e Apelit, Etikës dhe Integritetit.

Neni 23

Regjistri i antarësisë

1. Evidentimi i anëtarëve të Partisë Demokratike bëhet në Regjistrin Bazë të Anëtarësisë në format elektronik dhe shkresor, i cili përmban të dhënat e përditësuara për të gjithë anëtarët e regjistruar në Partinë Demokratike. Regjistri administrohet dhe përditësohet nga Sekretari i Degës.
2. Rregullat e hollësishme për formatin e regjistrit, administrimin, përditësimin dhe aksesimin e tij, përcaktohen me udhëzim të Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 24

Të drejtat dhe detyrat e anëtarit

1. Anëtari i PDSH-së ka të drejtë:

- a) të marrë pjesë dhe të shprehë lirisht mendimin e tij në mbledhjet e organeve të Partisë, si dhe në çdo veprimtari të PDSH-së;
 - b) të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e Partisë;
 - c) të propozojë për të gjitha organet legjislative e ekzekutive që përfaqësojnë PDSH sipas kushteve që parashikohen në këtë Statut.
- ç) t'u drejtohet për çështje vetjake e të Partisë të gjitha organeve drejtuese të saj.

2. Anëtari i PDSH-së ka për detyrë:

- a) të marrë pjesë rregullisht në organin ku bën pjesë, të jetë aktiv në veprimtarinë politike e elektorale të PDSH-së, si dhe të ndjekë jetën e brendshme organizative të saj;
 - b) t'i paguajë Partisë kuotën vjetore të anëtarësisë. Masa e kuotës vjetore dhe rregullat për shpërndarjen e saj ndërmjet selisë qendrore dhe strukturave lokale përcaktohen me vendim nga Kryesia e PDSH-së;
 - c) të paguajë kuotën e anëtarësisë brenda 60 ditëve nga data e thirrjes për pagimin e saj.
- ç) të respektojë disiplinën e Partisë të përcaktuar në këtë Statut, aktet nënstatutore dhe në aktet politike të shpallura nga PDSH.
3. Anëtarët e Partisë nuk mund të jenë njëkohësisht në më shumë se dy kryesi të organeve të Partisë pavarësisht nga niveli i tyre, me përjashtim të rasteve të pjesëmarrjes për shkak të funksionit që mban. Përkatësia në kryesitë e organizatave partnere nuk llogaritet.

Neni 25

Anëtarët me të drejtë vote

1. Anëtarë të PDSH-së, me të drejtë vote, janë të gjithë ata që përmbushin në mënyrë të njëkohshme kushtet e mëposhtme:

- a) kanë bërë anëtarësimin e tyre individual dhe janë pranuar e regjistruar si anëtar jo më vonë se 6 muaj përpara datës së zgjedhjeve të rradhës;
 - b) kanë paguar kuotën vjetore të anëtarësisë në masën e caktuar me vendim të Kryesisë së PDSH-së;
 - c) ndaj tyre nuk është marrë masa disiplinore e përjashtimit apo pezullimit nga partia apo nuk kanë dhënë dorëheqjen;
- ç) marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve ku bëjnë pjesë apo në veprimtaritë politike ku kërkohet.

2. Mospagimi për 2 vjet rresht i kuotës së anëtarësisë, si dhe mospjesëmarrja për gjashtë muaj në mbledhje të njëpasnjëshme të organeve ku bën pjesë apo në veprimtaritë politike, pa shkaqe të përligjura, sjell humbjen e të drejtës së votës si anëtar i PDSH-së, me vendim të Kryesisë së Degës. Personi që ka humbur të drejtën e votës mund të ankohet në Komisionin e Apelit, Etikës dhe Integritetit.

Neni 26

Përfundimi i anëtarësisë

1. Anëtarësia përfundon kur anëtari vdes, largohet me kërkesën e tij ose përjashtohet.
2. Çdo anëtar mund të largohet nga Partia me vullnetin e tij, duke njoftuar seksionin ku bën pjesë ose organin ku është i zgjedhur.

Neni 27

Masat disiplinore

1. Thyerja e disiplinës së brendshme të Partisë, ndërmarrja e veprimeve, në çdo formë apo mënyrë, që dëmtojnë interesat elektorale apo politike të PDSH-së, dhe mosplotësimi i detyrimeve të anëtarësisë sjell sanksione dhe kufizime të të drejtave të anëtarit të PDSH-së.
2. Masat disiplinore që mund të merren ndaj anëtarëve janë: paralajmërimi, pezullimi dhe përjashtimi. Këto masa merren sipas rastit nga Kryesia e Degës ose Kryesia e PDSH-së, dhe konfirmohen dhe/ose mund të apelojnë përpara Komisionit të Apelit, Etikës dhe Integritetit. Ato mund të bëhen publike.
3. Në tre muajt që paraprijnë çdo fushatë zgjedhore dhe një muaj pas saj, Kryesia e Partisë mund të deklarojë kundrejt

- d) propozimin e kandidaturave për drejtues dhe përfaqësues lokalë dhe qëndror të Partisë;
- dh) t'i sugjeruar dhe propozuar Degës/Grupseksionit trajtimin e çdo problemi që gjykon se është në interes të Partisë apo qytetarëve në territorin që mbulon.

6. Kryetari i Grupseksionit, me miratimin paraprak të Kryesisë së Degës, mund të thërrasë zgjedhje të parakohshme në Seksion, në rastet kur performanca zgjedhore është dukshëm e ulët, kur veprimtaria e seksionit është më e ulët se objektivat e caktuara nga Kryesia e Degës, apo kur kërkohet në mënyrë të argumentuar për shkak të neglizhencës së rëndë të organeve drejtuese të Seksionit.

Neni 31

Grupseksioni

1. Grupseksioni krijohet në bazë lagjeje, grup lagjesh apo në bazë fshatrash, ose në raste të veçanta dhe me miratim të Sekretarit të Përgjithshëm, mbi bazën e kriterëve specifike apo rrethanave të caktuara. Ai përbëhet nga seksionet e atyndodhura dhe secili grupseksion duhet të mbulojë një numër të përafërt zgjedhësish, sipas rregullave dhe numrit minimal e maksimal të zgjedhësve të përcaktuara me vendim të Kryesisë së PDSH-së. Kryesia e Degës vendos për ndarjen e degës në grupseksione dhe përcakton hartën dhe shtrirjen territoriale të çdo grupseksioni, të cilat miratohen me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm. Kryesia e Degës mund të vendosë edhe për ngritjen e grupseksioneve në emigracion apo mbi baza profesionale.
2. Grupseksioni drejtohet nga Kryetari, i cili zgjidhet çdo katër vjet, me votim të fshehtë, nga mbledhja e të gjithë anëtarëve të seksioneve në përbërje të atij Grupseksioni, sipas parimit "Një anëtar, Një votë". Numri i kandidaturave që i nënshtrohen votimit duhet të jetë të paktën dy. Të drejtën për të propozuar kandidatë e kanë 1/5 e anëtarëve të seksioneve që përfshihen në atë grupseksion, Kryesia e Degës, si dhe Kryetari i Degës.
3. Kryetari i Grupseksionit është përgjegjës për organizimin dhe mbarëvajtjen e punës në territorin e Grupseksionit. Veprimtaria e Kryetarit të Grupseksionit kontrollohet në mënyrë periodike nga Kryetari i Degës, i cili çdo 6 muaj raporton te Sekretari i Përgjithshëm i PDSH-së.
4. Pranë çdo Grupseksioni vepron Kryesia e Grupseksionit që përbëhet përveç Kryetarit, edhe nga:
 - a) Sekretari i grupseksionit, i cili emërohet nga Kryesia e Degës me propozim të Kryetarit të Degës.
 - b) kryetarët dhe sekretarët e seksioneve përbërëse;
 - c) anëtar i Këshillit Kombëtar dhe deputeti me banim aty;
 - ç) anëtarët e Kryesisë së Degës dhe të zgjedhurit vendorë me banim aty.
5. Kryesia e Grupseksionit mblidhen të paktën një herë në muaj me kërkesë të kryetarit të tij, Kryesisë apo Kryetarit të Degës, Kryesisë së PDSH-së, ose me kërkesë të jo më pak se 1/4 të anëtarëve të tij. Kryesia e Grupseksionit organizon punën për ndërmarrjen e aksioneve politike dhe/ose elektorale në territorin që mbulon.
6. Grupseksioni, dhe sipas rastit Kryesia e Grupseksionit, është përgjegjëse për:
 - a) organizimin e veprimtarisë politike në territorin e tij në përputhje me orientimet dhe qëndrimet e shpalluara të PDSH-së;
 - b) identifikimin dhe përditësimin e informacioneve mbi votuesit në territorin që mbulon duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me ta;
 - c) identifikimin dhe angazhimin në veprimtari politike të simpatizantëve të PDSH-së me banim në territorin përkatës;
 - d) organizimin dhe drejtimin e punës për operacionet elektorale gjatë zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore, sipas udhëzimeve të Kryetarit dhe/ose të Kryesisë së Degës;
 - e) pranimin e anëtarëve të rinj të PDSH-së;
 - f) propozimin për kandidatura për drejtues dhe përfaqësues lokalë dhe qëndror të Partisë;
 - g) t'i bërë sugjerime dhe propozime Degës për çdo problem që gjykon se është në interes të Partisë apo qytetarëve në territorin që mbulon.
7. Kryetari i Degës, me miratimin paraprak të Kryesisë së Degës, mund të thërrasë zgjedhje të parakohshme në Grupseksion, në rastet kur performanca zgjedhore është dukshëm e ulët, kur veprimtaria e grupseksionit është më e ulët se objektivat e caktuara nga Kryesia e Degës, apo kur kërkohet në mënyrë të argumentuar për shkak të neglizhencës së rëndë të organeve drejtuese të Grupseksionit.

Neni 32

Dega e PDSH-së

1. Dega e PDSH-së formohet apo shkrihet me vendim të Kryesisë së PDSH. Ajo funksionon përgjithësisht në bazë të njëjësive të qeverisjes lokale apo çdo ndarje tjetër administrative territoriale të përshtatshme dhe përbëhet nga grupseksionet dhe seksionet e atyndodhura.
2. Dega drejtohet në periudhën mes kuvendeve nga Kryetari dhe Kryesia e Degës.

- b) Kryetarët e Grupseksioneve të Degës;
- c) Sekretari i Degës si dhe Sekretarët Funkcionalë të Degës;
- ç) Deputetët e PDSH-së të zgjedhur në territorin e Degës apo që janë caktuar të mbulojnë Degën me vendim të Kryesisë së PDSH-së;
- d) Kryetari i Grupit të Këshilltarëve bashkiakë, si dhe Kryetari i Bashkisë dhe Kryetari i Këshillit Bashkiak, kur i përkasin PDSH-së;
- dh) Kryetari i Bordit Financiar;
- e) Kryetarin vendor të LDG dhe FRPD;
- ë) anëtarët e Këshillit Kombëtar të PDSH që kanë vendbanimin në Degë apo janë caktuar të mbulojnë Degën;
- f) vetëm në Degët qendër qarku, 7 (shtatë) anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Degës.

3. Në mbledhjet e Kryesisë së Degës marrin pjesë pa të drejtë vote edhe anëtarët e Bordit të Këshilltarëve.

4. Kryesia ushtron këto përgjegjësi dhe të drejta:

- a) i propozon Kryesisë së PDSH-së të paktën dy kandidatë për funksionin e Sekretarit të Degës;
 - b) zgjedh sekretarët funksionalë të Degës;
 - c) zgjedh Kryetarin e Bordit Financiar të Degës;
 - ç) zgjedh anëtarët e Bordit të Këshilltarëve, duke caktuar edhe fushat që do të mbulojnë secili prej tyre;
 - d) propozon strukturën organizative të Degës;
 - dh) drejton dhe organizon të gjithë veprimtarinë e Partisë në territorin ku vepron në përputhje me këtë Statut dhe aktet e nxjerra nga organet qendrore të Partisë, si dhe vendimet e detyrat e lëna nga kuvendi i Degës;
 - e) ndërhyt në rastet e shkeljes së akteve që rregullojnë funksionimin e brendshëm të Degës nga seksionet, grupseksionet dhe përcakton rregullat e procedurat për normalizimin e tyre;
 - ë) organizon dhe drejton zgjedhjet në strukturat lokale të Partisë si dhe fushatat elektorale;
 - f) formulon dhe paraqet para organeve eprore kërkesat dhe propozimet në emër të Degës së Partisë;
 - g) siguron dhe është përgjegjëse për veprimtarinë koherente të strukturave në varësi të saj, me veprimtarinë e përgjithshme të partisë në çështjet e organizimit, veprimtarive politike publike, veçanërisht të fushatave elektorale.
5. Mbledhja e Kryesisë thirret nga Kryetari të paktën një herë në muaj. Të drejtën e thirrjes së mbledhjes së Kryesisë së Degës për probleme të veçanta e kanë edhe 1/4 e anëtarëve të Kryesisë. Në këtë rast, kryetari njofton datën e mbledhjes jo më vonë se pesë ditë nga marrja e kërkesës.

Neni 36

Kryetari i Degës së PDSH-së

1. Kryetari i Degës së PDSH-së zgjidhet nga Kuvendi i Degës me votim të fshehtë nga jo më pak se dy kandidatura. Kandidaturat për Kryetar Dege duhet të jenë anëtarë prej të paktën 3 vjetësh dhe të plotësojnë kriteret që përcakton Kryesia e PDSH-së. Kandidaturat propozohen nga seksionet, Kryesia e Degës dhe Kryetari i Partisë. Kandidaturat e dala për kryetar të Degës i nënshtrohen një diskutimi dhe vlerësimi nga Kryesia e PDSH-së, e cila miraton përfundimisht propozimet për kandidaturat.
2. Kryetari i Degës përfaqëson anëtarësinë e partisë në territorin përkatës. Ai thërret dhe drejton mbledhjet e Kryesisë, fikson rendin e ditës në bashkëpunim me sekretarin e degës. Ai organizon funksionimin normal të Kryesisë dhe përgjigjet për zbatimin e vendimeve dhe orientimeve të saj. Ai përgjigjet për mbarëvajtjen e funksionimit të përditshëm të partisë dhe shprehjen e lirë të çdo anëtari të Kryesisë.
3. Kryetari i Degës ndihmohet në ushtrimin e veprimtarisë së tij nga Nënkryetarët e Degës, të cilët mbulojnë dhe janë përgjegjës drejtpërdrejt për veprimtarinë politike në një territor të caktuar elektorale, si dhe për detyra të tjera të caktuara nga Kryesia e Degës. Nënkryetarët e Degës zgjidhen nga Kryesia e Degës, me propozim të Kryetarit të Degës.

Neni 37

Sekretari i Degës

1. Sekretari i Degës ka për detyrë zbatimin e vendimeve të organeve qendrore të Partisë në Degën përkatëse dhe për dokumentimin e veprimtarisë së organeve të Degës. Ai mbikëqyr zgjedhjet në parti.
2. Sekretari i Degës emërohet nga Kryesia e PDSH-së dhe duhet të jetë të paktën tre vjet anëtar i PDSH-së.
3. Çdo vit dhe jo më vonë se fundi i tremujorit të parë pas mbylljes së vitit paraardhës, Sekretari i Degës i paraqet Kryesisë së Degës një raport të veprimtarisë së Degës, ku përfshihen veçanërisht anëtarësimet e reja në degë, përmbushja e detyrave të lëna nga organet qendrore të Partisë, financimi i Partisë dhe funksionimi organizativ i strukturave në Degë. Raporti pas diskutimeve dhe miratimit në Kryesinë e Degës, i dorëzohet Sekretarit të Përgjithshëm.
4. Sekretari i Degës në ushtrimin e detyrës së tij ndihmohet nga Sekretarët Funkcionalë të Degës, të cilët zgjidhen nga

Seksioni 1

Organet vendimmarrëse qendrore të PDSH-së

Neni 43

Kuvendi Kombëtar i Partisë

1. Kuvendi Kombëtar është organi më i lartë vendimmarrës i Partisë, që përbëhet nga:

- a) Kryetarët e seksioneve të Partisë Demokratike dhe sekretarët e grupseksioneve të Partisë Demokratike;
- b) Anëtarët e Kryesive të degëve, përfshirë anëtarët e Bordit të Këshilltarëve të Degës;
- c) Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike;
- ç) Anëtarët e Kryesisë së Partisë;
- d) Deputetët e Partisë Demokratike në Kuvendin e Shqipërisë;
- dh) Kryetarët e Bashkive, Prefekti, Kryetari i Qarkut, dhe këshilltarët vendorë, anëtarë të PDSH-së;
- e) koordinatorët tematikë apo koordinatorët e procesit zgjedhor në Degët e Partisë Demokratike, si dhe funksionarët e Selisë Qendrore të Partisë Demokratike;
- ë) Një numër i kufizuar përfaqësuesish të organizatave partnere në numër të barabartë jo më shumë se 5 për qind e numrit të anëtarëve të tjerë të Kuvendit Kombëtar.

2. Kuvendi Kombëtar mbledhet si rregull çdo katër vjet. Vendimin për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar e merr Këshilli Kombëtar ose Kryesia e PDSH-së, me propozim të Kryetarit të PDSH-së. Kuvendi mund të mbledhet edhe kur e kërkojnë 1/4 e anëtarëve të PDSH-së ose 1/4 e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar. Data e zhvillimit të Kuvendit dhe rendi i ditës njoftohen të paktën një muaj përpara ditës së parë të Kuvendit. Punimet e Kuvendit drejtohen nga një Komision i përbërë nga 5 anëtarë, i cili zgjidhet në fillim të Punimeve të tij, me propozimin e Kryetarit të Partisë.

3. Kuvendi Kombëtar ka kompetencë për:

- a) miratimin e Statutit të PDSH dhe ndryshimin e tij;
 - b) miratimin e programit të Partisë dhe linjave kryesore të politikës së saj, të cilat janë bazë pune për të zgjedhurit e PDSH-së në nivel qendror e vendor, si dhe për pushtetin ekzekutiv të drejtuar prej saj;
 - c) zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar;
 - ç) shkarkimin e Kryetarit të Partisë mbi bazën e një mocioni mosbesimi të miratuar nga më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar;
 - d) zgjedhjen e Kryetarëve të Nderit të PDSH, të cilët janë anëtarë me të drejtë vote në organet qendrore të PDSH-së për gjithë jetën;
 - dh) shpërndarjen e Partisë ose bashkimin me një ose disa parti të tjera;
4. Të drejtën për t'i bërë kërkesa dhe propozime Kuvendit Kombëtar, për çështje që janë në kompetencë të tij, përveç rasteve kur ky Statut përcakton ndryshe, e kanë Kryetari i Partisë, Këshilli Kombëtar, Kryesia e PDSH-së, ose jo më pak se pesëmbëdhjetë për qind e anëtarëve të Kuvendit me të drejtë vote, të shpërndarë në të paktën pesë Degë të PDSH-së.

Neni 44

Këshilli Kombëtar

1. Këshilli Kombëtar, në përputhje me programin, Statutin dhe vendimet e Kuvendit Kombëtar, drejton veprimtarinë politike të Partisë në periudhën midis dy Kuvendeve. Ai merr të gjitha vendimet e rëndësishme politike që mund të kërkojnë rrethanat dhe kur ato nuk janë parashikuar në këtë Statut si e drejtë vetëm e Kuvendit.

2. Këshilli Kombëtar përbëhet nga anëtarë për shkak të funksionit dhe anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi Kombëtar. Janë anëtarë të Këshillit Kombëtar për shkak të funksionit:

- a) anëtarët e Kryesisë së Partisë;
- b) anëtarët e Kolegjit të Kryetarëve;
- c) deputetët dhe ministrat në detyrë, anëtarë të PDSH-së;
- ç) kryetarët e Bashkive dhe Kryetarët e Këshillave të Bashkive dhe të Qarkut, që i përkasin Partisë Demokratike;
- d) ish-Presidentët, ish-Kryeministrat, ish-Kryetarët e Kuvendit dhe ish-Kryetarët e PDSH-së, që janë anëtarë të PDSH-së në momentin e mbledhjes së Këshillit Kombëtar;

3. Kuvendi Kombëtar zgjedh me votim të fshehtë jo më pak se 150 anëtarë të Këshillit Kombëtar, nga një listë e propozuar nga Kryetari i Partisë, ku numri i kandidatëve të mos jetë më pak se 1.5 herë më i madh se numri i vendeve që do të shpallen fitues dhe që njoftohet paraprakisht me vendim të Kryesisë së Partisë. Numri minimal i anëtarëve të zgjedhur nuk duhet të jetë më i vogël se numri i anëtarëve të Këshillit Kombëtar për shkak të funksionit. Numri i anëtarëve të zgjedhur të Këshillit Kombëtar nga gjinia më pak e përfaqësuar të mos jetë më pak se 30%, ndërkohë që numri i të rinjve deri në moshën 35 vjeç të mos jetë më pak se 15%. Nëse kuotat e mësipërme nuk plotësohen nga renditja e dalë pas votimit, atëherë renditja e tyre veçohet nga ajo e përgjithshmeja.

4. Këshilli Kombëtar drejtohet nga Kryetari i Këshillit, i cili zgjidhet në mbledhjen e parë të konstituimit të Këshillit

d) cakton kandidatët për deputetë, pas konsultimit me anëtarësinë e PDSH sipas parimit "Një anëtar, Një votë". Lista e kandidatëve për deputet i paraqitet për miratim Këshillit Kombëtar;

dh) ka të drejtë të vendosë për thirrjen e Kuvendit për zgjedhje të reja të Degës së Partisë dhe caktimin e organeve drejtuese të përkohshëm të degës në përputhje me këtë Statut;

e) miraton strukturën organike të PDSH-së dhe atë të pagave;

ë) ka të drejtë t'i adresohet, secili prej anëtarëve të saj, edhe çdo kryesi dege, e organizatë partnere;

f) ndërhyrë dhe mund të refuzojë kandidaturat e përzgjedhura nga organet vendore të Partisë.

4. Të drejtën për të kërkuar thirrjen e mbledhjes dhe për të propozuar vendime Kryesisë së Partisë e kanë Kryetari i Partisë, Sekretari i Përgjithshëm ose 1/5 e anëtarëve të Kryesisë. Vendimet në Kryesi merren me shumicë të thjeshtë të votave në prani të më shumë se gjysmës së anëtarëve të Kryesisë. Në rast se nuk sigurohet kuorumi i nevojshëm, atëherë mbledhja vijuese e saj për të njëjtin rend dite zhvillohet pavarësisht nga kuorumi.

Neni 46

Kryetari i Partisë

1. Kryetari i Partisë kryeson organet qendrore të Partisë dhe siguron zbatimin e vendimeve të tyre. Ai përfaqëson Partinë në të gjitha veprimtaritë publike e politike, të brendshme dhe ndërkombëtare.

2. Kryetari i Partisë zgjidhet me votim të të gjithë anëtarëve të PDSH, sipas parimit "Një anëtar, Një votë". Modalitetet e procesit përcaktohen në aktet nënstatutore.

3. Kryetari i Partisë ndihmohet nga Nënkryetarët dhe Sekretari i Përgjithshëm. Kryetari i Partisë në varësi të problematikave apo çështjeve specifike mund të ngrëjë struktura ndihmëse apo të caktojë koordinatore apo të deleguar, të cilat merren me shqyrtimin dhe zgjidhjen e tyre, apo drejtimin e procesit të ngarkuar.

4. Kryetari i Partisë gjatë veprimtarisë së tij të përditshme i cakton detyra dhe fusha të caktuara përgjegjësie Nënkryetarëve të Partisë. Në mungesë të zgjatit të kryetarit dhe me autorizim të tij, njëri prej tyre zëvendëson Kryetarin. Në mungesë të këtij autorizimi, duke përfshirë rastet e dorëheqjes nga detyra të Kryetarit, Sekretari i Përgjithshëm mbledh Këshillin Kombëtar, i cili komandon Nënkryetarin që do të drejtojë Partinë deri në rikthimin e Kryetarit në detyrë apo zgjedhjen e Kryetarit të ri.

5. Kryetari i Partisë në përmbushje të funksioneve të tij dhe garantimit të mbarëvajtjes së punës në parti, nxjerr urdhra dhe udhëzime, në bazë dhe për zbatim të këtij Statuti, si dhe të vendimeve të organeve drejtuese të Partisë.

Neni 47

Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për organizimin e partisë, si dhe për funksionimin e përditshëm të saj. Ai organizon dhe ndjek zbatimin e akteve të nxjerra nga organet qendrore të partisë në degët e PDSH-së.

2. Sekretari i Përgjithshëm në ushtrimin e kompetencave të tij ndihmohet nga Sekretarët Funkcionalë, që emërohen nga Këshilli Kombëtar dhe mbulojnë fushat e veprimtarisë që përcaktohen me udhëzim të Kryetarit të PDSH-së.

Neni 48

Grupi Parlamentar i Partisë

1. Grupi Parlamentar i PDSH-së përbëhet nga deputetët e saj në Kuvendin e Shqipërisë.

2. Grupi Parlamentar i PDSH-së:

a) përfaqëson në Parlament PDSH-në dhe siguron aty mbrojtjen e platformës, programit dhe interesave të PDSH-së;

b) harton programin dhe përcakton mënyrën e veprimit e të angazhimit të deputetëve të tij në Parlament dhe në zonat elektorale përkatëse;

c) vendos për ndarjen e anëtarëve të tij në komisionet parlamentare;

ç) harton rregulloren e funksionimit të Grupit Parlamentar;

d) i propozon Këshillit Kombëtar për çështjet që janë kompetencë e këtij të fundit.

Seksioni 2

Organet të tjera qendrore të PDSH-së

Neni 49

Kolegji i Kryetarëve

1. Kolegji i Kryetarëve, përbëhet nga të gjithë Kryetarët e Degëve të PDSH-së, dhe është strukturë ndihmëse dhe këshillimore e Kryetarit të Partisë.

2. Kolegji i Kryetarëve, ushtron këto përgjegjësi:

a) diskuton mënyrën e përmbushjes së detyrave në kuadër të një aksioni apo aktiviteti politik, sipas vendimeve të marra

3. Gjatë shqyrtimit të ankesave kundër masave disiplinore, Komisioni siguron të drejtën e anëtarit për një proces të rregullt ligjor. Vendimi i Komisionit është i paapelueshëm. Kur një Kryesia vendos të marrë një sanksion kundrejt një anëtarit që mban një mandat zgjedhor, ekzekutiv ose parlamentar, ai nuk mund të bëhet publik veçse nëse vendos Kryesia e PDSH-së. Në të gjitha rastet e tjera, Komisioni deklaron vetë publikisht vendimet që merr.
4. Komisioni me kërkesë të Kryesisë së Partisë, shprehet për mospërputhjet e vendimeve të marra nga organet qendrore, kryesitë apo anëtarët, me Statutin e Partisë, si dhe jep vlerësim mbi interpretimin përfundimtar të dispozitave të Statutit. Ai thërret për dëgjim, sipas rastit, të interesuarit.

KREU VI

VEPRIMTARIA EKONOMIKE E PARTISË

Neni 55

Financat e Partisë

1. Burimet financiare të Partisë përbëhen nga kuotizacionet e anëtarësisë, nga granti që jep buxheti i shtetit sipas ligjit, nga ndihma e dhurata publike që njeën ligji për partitë politike, si dhe nga çdo financim apo burim tjetër që lejon ligji.
2. Masa e kuotës së anëtarësisë përcaktohet nga Kryesia e Partisë. Rregullat për mbledhjen, administrimin dhe përdorimin e kuotave të anëtarësisë përcaktohen në aktet nënstatutore.
3. Bilancet, ku përfshihen të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe Buxheti Vjetor i Partisë, pasi raportohen pranë organeve kompetente sipas ligjit, bëhen publike në faqen zyrtare në internet të PDSH-së.

Neni 56

Bordi Financiar i Partisë

1. Bordi Financiar i Partisë përbëhet nga pesë anëtarë të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar.
2. Kryetari i Bordit është përgjegjës për administrimin e fondeve të Partisë. Ai i kërkon Kryesisë të shprehet për projektin e buxhetit dhe jep llogari para saj për zbatimin e këtij buxheti. Bordi Financiar, paraqet një opinion për projektin e buxhetit dhe propozon për miratim nga Kryesia e Partisë rregullat e përdorimit të fondeve të partisë.
3. Bordi kontrollon përdorimin rigoroz të financave të partisë. Në këtë funksion, ai mblidhet për të dhënë mendim para dorëzimit të bilancit të partisë në organet kompetente shtetërore dhe të partisë; si dhe para paraqitjes së buxhetit në Kryesinë e Partisë. Bordi mund të mblidhet edhe me kërkesën e më se gjysmës së anëtarëve për të nxjerrë rekomandime për administrimin financiar të partisë. Këto rekomandime kanë fuqi zbatuese për Kryesinë e Partisë.

Neni 57

Detyrimet pasurore

1. Kryesia e PDSH-së nuk mund të marrë përsipër detyrime sipas të cilave anëtarët e saj përgjigjen me pasurinë personale.
2. Për detyrime tregtare ligjore të Partisë, anëtarët e organeve përkatëse përgjigjen vetëm me pasurinë e Partisë.
3. Organet e Partisë janë përgjegjëse për detyrimet e një organi më të ulët vetëm në rastin kur ato e kanë miratuar këtë detyrim.

KREU VII

ORGANIZATAT PARTNERE

Neni 58

Organizatrat partnere

1. Partia ka këto organizata partnere:
 - a) Forumin Rinor të Partisë Demokratike (FRPD);
 - b) Lidhjen Demokratike të Gruas (LDG);
2. PDSH-ja mbështet veprimtarinë politike të organizatave partnere në gjithë territorin e vendit. Organizatat partnere synojnë që të promovojnë idetë dhe programet e PDSH në grupet shoqërore ku ato veprojnë, si edhe të paraqesin e mbrojnë interesat e këtyre grupeve në politikën e PDSH-së.
3. PDSH-ja garanton përfaqësimin e organizatave partnere në të gjitha nivelet e përfaqësimit politik, ku përfaqësimi i LDG është në standardin minimum të parashikuar nga ligji elektorale, ndërkohë që përfaqësimi i FRPD është më standartin minimal 10 për qind të të zgjedhurve në Këshillat Vendorë, si dhe me 5 për qind të listës së kandidatëve për në Kuvendin e

f		
(http		
s://w		
ww.f		(http
aceb	(http	s://w
ook.	s://t	ww.y
com	witte	outu
/part	r.co	be.c
iade	m/p	om/
mok	dshq	dem
ratik	iperi	okra
e))	tet)



[shqiptarja.com]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER LAURA L. PUSTINA



V2023053330039029384

DATE 02/03/2023
NR REP 568

VËRTETIM I KOPJES
SE NJËJTË ME DOKUMENTIN

Sot, më datë 02/03/2023, para meje Noteres LAURA L. PUSTINA, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Njësia Administrative n. 5, Rr. Abdyl Frasheri, P. nr. 31, Ap. 6, kati 3, u paraqit personalisht: Ivi Kaso, atësia Spiro, amësia Loreta, shtetas Shqiptar, lindur në Përmet dhe banues në TIRANË, me adresë Faik Konica, Nd. 21; H. 2; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1010; Tiranë, lindur më 11/03/1979, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033944850 dhe nr. personal H90311124P, i cili me kërkoi të hap faqen zyrtare të Partise Demokratike dhe ne te hap dhe shkarkoj Statutin e Partise Demokratike dhe te vertetoj kopjen e tij.

Linku <https://pd.al/statuti/> u hap nga une noteria dhe dokumenti ne te, bashkelidhur ketij vertetimi, u printua ne zyren time noteriale.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja “i”, nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”; Vërtetoj se kopja e dokumentit të printuar prej meje noteres nga linku i mesiperm është e njëjtë me dokumentin e permbajtur ne kete link.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE
LAURA L. PUSTINA

